



**PARTNERËT** SHQIPËRI  
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

## **Matrica e Monitorimit**

mbi Mjedisin Mundësues për  
Zhvillimin e Shoqërisë Civile

**RAPORTI**

**PËR SHQIPËRINË 2017**

© 2018, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

Rruga Sulejman Delvina, N.18, H.8, Ap. 12, Njësia Bashkiake 5,  
Kodi Postar 1022, Tiranë, Shqipëri,  
Kutia Postare (PO Box) 2418/1  
Tel.Faks: +355 4 2254881

@ [partners@partnersalbania.org](mailto:partners@partnersalbania.org)

 [www.partnersalbania.org](http://www.partnersalbania.org)



### Ekipi i studimit

Juliana Hoxha

Klotilda Tavani

Anora Topi

Kostandina Këruti

# Tabela e Përmbajtjes

<b>I. Përmbledhje Ekzekutive</b> .....	5
Shoqëria Civile dhe Zhvillimi i Shoqërisë Civile në Shqipëri.....	5
Gjetjet kryesore.....	8
Rekomandimet kryesore.....	9
Rreth Matricës.....	10
<b>II. Hyrje</b> .....	11
Rreth raportit të monitorimit.....	11
Matrica e e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile .....	11
Mirënjohje.....	12
<b>III. Metodologjia</b> .....	13
Përmbledhje e përqasjes metodologjike.....	13
<b>IV. Gjetje dhe Rekomandime</b> .....	14
Fusha 1: Garancitë Themelore Juridike të Lirive.....	14
Fusha 2: Kuadri për Qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat Financiare për OSHC-të .....	18
Fusha 3: Marrëdhënia Shtet - OSHC .....	26
<b>V. Burime të përdorura dhe lidhje të dobishme</b> .....	31



# Përmbledhje Ekzekutive

## SHOQËRIA CIVILE DHE ZHVILLIMI I SHOQËRISË CIVILE NË SHQIPËRI

### Garancitë themelore juridike të lirive:

Organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri gëzojnë lirinë e organizimit bazuar në kuadrin ligjor aktual. Edhe pse legjislacioni nuk ndryshoi gjatë vitit 2017, ende ai ka nevojë për përmirësime për sa i përket procedurave të regjistrimit të organizatave jofitimprurëse. Sipas informacionit zyrtar të marrë nga institucionet publike dhe duke iu referuar konsultimeve me përfaqësuesit e sektorit përgjatë vitit, ka të dhëna kontradiktore lidhur me regjistrimin, përbërjen dhe veprimtarinë e OSHC-ve: Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë raporton të ketë regjistruar rreth 7,383 OSHC, ndërsa vetëm 4,136 janë regjistruar në Administratën Tatimore<sup>1</sup>. Gjatë vitit 2017 u regjistruan 345 OSHC të reja (198 Shoqata, 61 Fondacione dhe 86 Qendra) dhe vetëm 238 prej tyre janë regjistruar në Administratën Tatimore. Ndërtimi i një baze të dhënash të integruar me informacione të detajuara nga disa institucione për organizatat e shoqërisë civile në Shqipëri, një aktivitet me prioritet të lartë edhe i Udhërrëfyesit për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Shoqërinë Civile 2013-2017, është ende larg. Kjo bazë e të dhënave jo vetëm që do të sigurojë informacion të saktë për sektorin, por do të mundësonte gjithashtu një trajtim të diferencuar tatimor të OSHC-ve në përputhje me natyrën e tyre jo-fitimprurëse dhe llojin e aktiviteteve që kryejnë. OSHC-të raportojnë se kanë qenë subjekt i kontrolleve të shpeshta nga inspektorët tatimorë për shkak të fushatave kundër informalitetit të iniciuara nga qeveria gjatë 2017.

Edhe pse pranohet se sjellja dhe komunikimi me zyrtarët e taksave është përmirësuar disi, problematike mbetet njohuria e kufizuar dhe i kuptuari i natyrës jo fitimprurëse të OSHC-ve. Përpjekjet e zyrtarëve shtetëror (institucionet

qeveritare qendrore dhe vendore) për të trajtuar sektorin njësoj si bizneset vazhdojnë të jenë një rrezik konstant për qëndrueshmërinë e OSHC-ve, sidomos ato të sapokrijuara. Shembuj të qartë të kësaj sjelljeje janë: 1) vendosja e gjobave për vullnetarët duke i quajtur si “punonjës të paregjistruar” gjatë inspektimeve tatimore, 2) kërkesa e parapagimit të detyrimit të vlerësuar para apelimit tek autoritetet tatimore sikurse biznesi, 3) klasifikimi i OSHC-ve njësoj me biznesin në lidhje me taksat dhe tarifatat vendore etj.

Lidhur me lirinë e tubimit paqësor nevojiten përmirësime në legjislacionin aktual, i cili nuk është ndryshuar që nga viti 2001, kryesisht në aspektin e njohjes së tubimeve spontane, komunikimit të njoftimit përpara tubimit, unifikimit të sanksioneve në Ligj dhe në Kodin Penal si dhe qartësimin e procedurave të apelimit që duhet të ndiqen nga organizatorët në rastet kur ata ndjehen të dhunuar për të ushtruar të drejtën e tyre<sup>2</sup>. Gjatë vitit 2017 organizatat e shoqërisë civile janë angazhuar në shumë tubime ku kanë shprehur shqetësimet e tyre lidhur me çështjet për të cilat ato advokojnë, siç janë mbrojtja e mjedisit, mbrojtja e të drejtave të njeriut etj.

### Qëndrueshmëria financiare dhe lehtësirat financiare të OSHC-ve:

Në legjislacionin aktual nuk është bërë asnjë përmirësim lidhur me trajtimin fiskal për vitin 2017. Rreth 60% e sektorit është ende i regjistruar për TVSH dhe detyrimet e sektorit ndaj Administratës Tatimore janë rritur. Interpretimi i ligjeve fiskale nga inspektorët tatimorë është ende një problem në të gjithë vendin dhe nuk ka pasur ndonjë përpjekje nga ana e institucioneve shtetërore për

<sup>1</sup> Informacioni i marrë sipas kërkesës zyrtare të dërguar në institucionet përkatëse nga Partnerët Shqipëri

<sup>2</sup> Monitorimi i së Drejtës për Tubime Paqësore – Raporti për Shqipërinë 2016-2017. Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, ECNL  
<http://partnersalbania.org/publication/monitoring-right-to-free-assembly-albania-country-report-2016-2017/>

të korrigjuar situatën edhe këtë vit. OSHC-të nuk trajtohen sipas natyrës së tyre jo fitimprurëse në rastet e apelimit të vendimeve administrative të inspektorëve tatimorë, duke zbatuar kushtin e parapagimit të detyrimit total para apelimit. Skema e rimbursimit të TVSH-së për projektet e mbështetura nga fondet IPA nuk ka rezultuar e suksesshme dhe nuk ka pasur asnjë përmirësim edhe sa i përket fushëveprimit të saj. Sipas të dhënave zyrtare të marra nga Administrata Tatimore për periudhën 2015-2017, vetëm një projekt është rimbursuar, ndërkohë që janë dhënë gjithsej tetë certifikata regjistrimi projektesh për rimbursimin e TVSH-së. Procedura aktuale e rimbursimit është e zgjatur në kohë dhe pengon qëndrueshmërinë financiare të OSHC-ve, ndërsa rimbursimi i TVSH-së të mekanizmave dhe instrumenteve të tjerë të financimit të BE në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar (si EIDHR, IPA ndërkufitare, Erasmus+, etj.) nuk është ende i rregulluar në ligj dhe i përshtatshëm për sektorin. Sa i përket përjashtimit të TVSH-së për veprimtaritë e OSHC-ve të klasifikuara sipas kuadrit ligjor si “aktivitete me interes të publikut të gjerë”, ka qenë gjithashtu i pasuksesshëm edhe për shkak të procedurave të zgjatura dhe të komplikuar, si dhe aktiviteteve të kufizuara. Në lidhje me stimujt për donacionet e individëve dhe korporatave, edhe për 2017, nuk pati ndonjë ndryshim në legjislacion. Legjislacioni i vetëm në fuqi mbetet Ligji për Sponsorizimet, ndërkohë që aktiviteti filantropik duhet të njihet dhe rregullohet me një ligj të veçantë, si një aktivitet më vete. Vetëm duke pasur kuadër ligjor të përshtatshëm, mjedisi për dhurimet e korporatave dhe individëve mund të përmirësohet. Në lidhje me alokimin e fondeve publike për OSHC-të, nuk ka të dhëna të publikuara për fondet e përgjithshme publike të ndara për sektorin nga të gjitha institucionet publike, qendrore apo lokale. Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) mbetet burimi kryesor në nivel kombëtar, duke shpallur çdo vit një thirrje për projekt propozime me një shumë totale prej 754,000 EUR, si dhe mbështetje institucionale (20 OSHC kanë përfituar mbështetje institucionale gjatë 2017).

Në përgjithësi, institucionet kanë rregulla dhe procedura në lidhje me transparencën, ndërkohë që nuk ka qartësi dhe informacion mbi projektet e shpallura fituese. Përmirësime janë bërë në kuadrin ligjor sa i përket Ligjit për Inspektimin Financiar Publik si dhe janë miratuar procedurat dhe manualët mbështetëse. Megjithatë, në

raportet përfundimtare të inspektimit të publikuara, në faqen e internetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nuk tregohet periudha dhe burimi i financimit, subjekte të inspektimeve të kryera. Detyrimi për të raportuar të paktën një punonjës me orar të plotë ende zbatohet për të gjitha organizatat, duke paraqitur kështu një pengesë të vazhdueshme ndaj nismës së lirë të individëve për të krijuar organizata jofitimprurëse dhe për të promovuar vullnetarizmin si një vlerë njerëzore në mbështetje të njerëzve në nevojë. Aktet nënligjore të përcaktuara në Ligjin për Vullnetarizmin për të rregulluar marrëdhëniet midis vullnetarit dhe ofruesit të vullnetarizmit (siç janë regjistri i kontratave, broshura dhe kodi etik për vullnetarizmin) ende nuk janë aprovuar.

**Bashkëpunimi Shtet - OSHC:** Me miratimin e Udhërrëfyesit për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Shoqërinë Civile, Fletorja Zyrtare 94/2015, qeveria njohu rëndësinë e zhvillimit dhe bashkëpunimit me sektorin. Udhërrëfyesi u pasua me themelimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile, një organ konsultativ i përbërë nga përfaqësues të qeverisë dhe shoqërisë civile, që do të garantojnë bashkëpunimin institucional midis dy sektorëve, në mbështetje të qeverisjes së mirë, promovimit të demokracisë me pjesëmarrje, dhe rritjes së transparencës përmes gjithëpërfshirjes së shoqërisë civile në këtë proces. Për fat të keq, zbatimi i Udhërrëfyesit dhe funksionimi i këshillit nuk ka ndjekur të njëjtën shpejtësi të miratimit të tyre. Shumica e aktiviteteve apo veprimeve të propozuara të Udhërrëfyesit nuk janë zbatuar ende, ndërsa Këshilli ka dështuar të arrijë ndonjë rezultat. Deri në fund të vitit 2017, me një asistencë teknike të ofruar nga Delegacioni i BE-së në Shqipëri, Kryeministria filloi për herë të parë miratimin e një procesi monitorimi, rishikimi dhe përmirësimi të Udhërrëfyesit.

Kuadri ligjor i cili rregullon përfshirjen e OSHC-ve në proceset politikë-bërëse dhe vendim-marrëse nuk ka ndryshuar në vitin 2017. Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe Ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” janë ligjet kryesore që garantojnë të drejtën e OSHC-ve dhe qytetarëve për përfshirjen në proceset politikë-bërëse dhe vendim-marrëse. Këto ligje kanë kontribuar në rritjen e komunikimit dhe transparencës së institucioneve publike me qytetarët. Gjithashtu, vihet re një rritje e

ndërgjegjësimit të institucioneve publike mbi detyrimet e tyre ligjore për të siguruar informacion dhe përfshirjen e qytetarëve në proceset politikë-bërëse dhe vendim-marrëse. Megjithatë, sasia dhe cilësia e informacionit të siguruar nga institucionet publike mbetet problematik, veçanërisht në rastet kur informacioni i kërkuar është sensitiv. OSHC-të kanë qenë shumë aktive në përdorimin e këtyre ligjeve gjatë punës së tyre, dhe vetëdija e tyre për të ushtruar të drejtën për ankesë është rritur ndjeshëm. Siç dëshmohet nga të dhënat e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale, në vitin 2017 janë regjistruar 130 ankesa nga OSHC për të drejtën e informimit. Më problematike është situata e transparencës me institucionet e qeverisë qendrore, veçanërisht pas zgjedhjeve parlamentare të qershorit që rezultuan me ristrukturimin e qeverisë, duke çuar në një përkeqësim të ndjeshëm të zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit.

Niveli i transparencës nga ana e bashkive është duke u përmirësuar, por mënyrat e bashkëpunimit ndërmjet OSHC-ve dhe pushtetit lokal janë ende të kufizuara, për shkak të: numrit të kufizuar

të takimeve të hapura në bashkitë ku OSHC-të angazhohen dhe japin zë për shqetësimet e qytetarëve, kapacitetet e dobëta të OSHC-ve për të lobuar, advokuar dhe ndikuar në vendim-marrjen e institucioneve lokale, si dhe mungesës së OSHC-ve në bashkitë më të vogla. Problematike mbetet edhe situata me transparencën e procesit të përzgjedhjes së përfaqësuesve të OSHC-ve në organet ndër-sektoriale për të cilat nuk ekziston gjithashtu një kuadër ligjor specifik për të rregulluar përfshirjen e OSHC-ve në proceset politikë-bërëse dhe vendim-marrëse, si dhe kriteret e përzgjedhjes.

Sa i përket bashkëpunimit në ofrimin e shërbimeve, rregullat e tenderimit janë të unifikuara dhe zbatohen në mënyrë të njëjtë nga OSHC-të dhe subjektet e tjera private, me çmimin dhe jo cilësinë, duke mbetur kështu kriter kryesor i shpalljes së fituesit, duke vendosur OSHC-të në një situatë të pafavorshme. Kuadri ligjor për zbatimin e Ligjit për Ndërmarrjet Sociale ende nuk është plotësuar dhe nevoja për një procedurë të re të prokurimit social, për të siguruar një kontraktim efektiv të OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve, nuk është adresuar.

## Gjetjet kryesore

NR.	6 gjetjet kryesore të studimit	Referenca në Matricën e Monitorimit		Referenca në Udhëzuesin e BE-së	
		Fusha		Objektivi	
1	Çështjet që lidhen me centralizimin e procesit të regjistrimit të OSHC-ve në Gjykatën e Shkallës së Parë të Tiranës dhe që paraqesin kosto të larta financiare dhe njerëzore nuk janë adresuar, siç ishte planifikuar në “Udhërrëfyesin për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Shoqërinë Civile”.	<b>Fusha</b>	<b>1</b>	<b>Objektivi</b>	<b>1</b>
		Nën-fusha	1.1	Rezultati	1.1
2	Nuk ka bazë ligjore dhe rregullore për çregjistrimin e OSHC-ve të regjistruara në mënyrë të padrejtë në skemën e TVSH-së dhe tatimit mbi fitimin gjatë periudhës 2008 -2014.	<b>Fusha</b>	<b>2</b>	<b>Objektivi</b>	<b>2</b>
		Nën-fusha	2.1	Rezultati	2.3
3	Nuk ka një kuadër ligjor që të rregullojë veprimtarinë filantropike dhe të ofrojë stimuj fiskalë për dhurimet e kompanive si dhe ato individuale. Përveç kësaj, nuk ekzistojnë politika shtetërore që nxisin bashkëpunimin midis OSHC-ve dhe donatorëve për kanalizimin e dhurimeve të tyre përmes OSHC-ve.	<b>Fusha</b>	<b>2</b>	<b>Objektivi</b>	<b>2</b>
		Nën-fusha	2.2	Rezultati	2.2
4	Zbatimi i “Udhërrëfyesit për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Shoqërinë Civile” të miratuar në vitin 2015, si dokumenti kryesor strategjik i qeverisë që njih rëndësinë për zhvillimin dhe bashkëpunimin me sektorin, nuk ka pasur progres në pjesën më të madhe të veprimeve të propozuara.	<b>Fusha</b>	<b>3</b>	<b>Objektivi</b>	<b>3</b>
		Nën-fusha	3.2	Rezultati	3.1
5	Roli i Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile në krijimin e një mjedisi mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile në vend në vitin e parë të punës së tij ka qenë i dobët dhe pa rezultate konkrete.	<b>Fusha</b>	<b>3</b>	<b>Objektivi</b>	<b>3</b>
		Nën-Fusha	3.2	Rezultati	3.1
6	Kuadri ligjor dhe rregullator aktual nuk bën të mundur angazhimin kuptimplotë të OSHC-ve në ofrimin e shërbimeve të ndryshme përmes kontratave shtetërore, dhe aktet ligjore për zbatimin e Ligjit për Ndërmarrjet Sociale që priten të përmirësojnë situatat, nuk janë përgatitur dhe miratuar.	<b>Fusha</b>	<b>3</b>	<b>Objektivi</b>	<b>3</b>
		Nën-Fusha	3.3	Rezultati	3.1



## Rekomandimet Kryesore

No	6 rekomandimet më të rëndësishme për reformë	Referenca në Matricën e Monitorimit		Referenca në Udhëzuesin e BE-së	
		Fusha		Objektivi	
1	Përgatitja e kuadrit të ri ligjor për decentralizimin e procesit të regjistrimit dhe ri-regjistrimit të OSHC-ve në nivel lokal.	Fusha	1	Objektivi	1
		Nën-Fusha	1.1	Rezultati	1.1
2	Krijimi i një regjistri të unifikuar elektronik të OSHC-ve ku të përfshijë informacione (numri, fusha e veprimit, shpërndarja gjeografike, forma ligjore, numri i punonjësve dhe vullnetarëve, qarkullimi vjetor, burimet e financimit etj.) që do të përdoren nga të gjitha institucionet përkatëse përgjegjëse për regjistrimin e OSHC-ve si dhe rregullimin e veprimtarisë së tyre.	Fusha	1	Objektivi	1
		Nën-Fusha	1.1	Rezultati	1.1
3	Përgatitja e një procedure të veçantë dhe të qartë për çregjistrimin e të gjitha OSHC-ve të regjistruara gabimisht në skemën e TVSH-së gjatë periudhës 2008-2014. Procedura duhet të parashikohet në ligj dhe të publikohet, shoqëruar me udhëzime specifike për strukturën përgjegjëse për zbatimin e saj. Trajnimet e përfaqësuesve të OSHC-ve dhe inspektorëve tatimorë do të jenë të nevojshme për zbatimin e suksesshëm të procedurës.	Fusha	2	Objektivi	2
		Nën-Fusha	2.1	Rezultati	2.3
4	Njohja e aktivitetit filantropik me ligj të veçantë për ta promovuar dhe rregulluar atë si një aktivitet më vete nga sponsorizimi. Në këtë kontekst, është e rëndësishme të rriten stimujt fiskalë për dhurimet e korporatave dhe të ofrohen stimujt fiskalë për dhurimet individuale. Të përgatiten aktet e nevojshme ligjore dhe nënligjore ku të parashikohen lehtësira që inkurajojnë partneritetin midis OSHC-ve dhe sektorit privat, si dy aktorë të rëndësishëm në zhvillimin e filantropisë në vend, bazuar kjo edhe në modelet ekzistuese lokale apo praktika të mira ndërkombëtare.	Fusha	2	Objektivi	2
		Nën-Fusha	2.2	Rezultati	2.2
5	Përgatitja e një plani veprimi konkret për zbatimin e veprimeve të propozuara në "Udhërrëfyesin për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Shoqërinë Civile", brenda afateve kohore. Rritja e bashkëveprimit dhe llogaridhënies së anëtarëve të shoqërisë civile në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile për të siguruar përfaqësim të gjerë të sektorit në dialogun me qeverinë.	Fusha	3	Objektivi	3
		Nën-Fusha	3.2	Rezultati	3.1
6	Përgatitja dhe miratimi i akteve ligjore në mbështetje të zbatimit të Ligjit për Ndërmarrjet Sociale, përmes një procesi të hapur konsultativ dhe duke marrë parasysh rekomandimet e ofruara nga OSHC-të.	Fusha	3	Objektivi	3
		Nën-fusha	3.3	Rezultati	3.1

## Rreth Matricës

Ky Raport Monitorimi publikohet çdo vit që nga viti 2013. Monitorimi bazohet në Matricën e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (CSDev) të zhvilluar nga Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (BCSDN) dhe Qendra Evropiane për Ligjin Jofitimprurës (ECNL). Ai është pjesë e një serie raportimesh vendore që mbulon shtatë vende në Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë.

Matrica e Monitorimit prezanton parimet dhe standardet kryesore, ekzistenca e të cilave është thelbësore në mënyrë që mjedisi ligjor të konsiderohet mbështetës dhe mundësues për funksionimin e OSHC-ve. Matrica është e organizuar në tri fusha, dhe secila prej tyre ndahet në nën-fusha: (1) Garancitë Themelore Juridike të Lirive; (2) Kuadri për Qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat Financiare të OSHC-ve; (3) Marrëdhënia Qeveri - OSHC.

Parimet, standardet dhe indikatorët janë formuluar duke marrë në konsideratë stadin aktual të zhvillimit të sektorit dhe diversitetin e vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë. Ato mbështeten në liritë dhe të drejtat e garantuara në mënyrë ndërkombëtare dhe praktikrat më të mira rregullatore në nivelin e Bashkimit Evropian dhe të vendeve të Evropës. Matrica synon të përcaktojë një situatë optimale të dëshiruar për shoqërinë civile që ajo të funksionojë e të zhvillohet në mënyrë efektive dhe synon gjithashtu të vendosë një kuadër realist i cili të mund të ndiqet dhe zbatohet nga autoritetet publike. Duke pasur parasysh se sfidat kryesore qëndrojnë kryesisht në zbatim, indikatorët janë përcaktuar për të monitoruar gjendjen në nivelin e kuadrit ligjor dhe zbatimin praktik të tij.

## II. Hyrje

### Rreth Raportit të Monitorimit

Partnerët Shqipëri realizuan për të pestin vit radhazi studimin për Raportin e Matricës së Monitorimit 2017. Ky raport monitorues synon të prezantojë një pasqyrë të çështjeve që lidhen me mjedisin mundësues të OSHC-ve në Shqipëri, duke përfshirë kuadrin ligjor aktual, zbatimin praktik të tij, si dhe të japë rekomandime se si mund të adresohen dhe të trajtohen këto çështje.

Raporti i Matricës së Monitorimit 2017, i përgatitur nga Partnerët Shqipëri, bazohet në shqyrtimin e legjislacionit shqiptar, politikave, studimeve dhe raporteve të përdorura për vlerësimin e indikatorëve ligjorë të Matricës së Monitorimit, si dhe konsultimet me OSHC-të për të vlerësuar indikatorët e praktikës së saj.

### Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile

Matrica e Monitorimit prezanton parimet dhe standardet kryesore, ekzistenca e të cilave është thelbësore në mënyrë që mjedisi ligjor të konsiderohet mbështetës dhe mundësues për funksionimin e OSHC-ve. Ajo nënvizon faktin se mjedisi mundësues është një koncept kompleks, i cili përfshin fusha të ndryshme dhe varet nga faktorë të ndryshëm, nga faza të zhvillimit të shoqërisë dhe nga sektori i shoqërisë civile.

Matrica është e organizuar në tre fusha, e ndarë secila në nën-fusha:

1. Garancitë Themelore Juridike të Lirive;
2. Kuadri për Qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat Financiare për OSHC-të;
3. Marrëdhënia Qeveri-OSHC.

Kjo Matricë nuk ka për qëllim të mbulojë të gjitha çështjet e mjedisit mundësues, por thekson ato që ekspertët kanë përcaktuar si më të rëndësishmet për vendet në të cilat ata kanë kryer vepërimitarinë e tyre. Standardet dhe indikatorët janë formuluar duke marrë në konsideratë gjendjen aktuale të zhvillimit të sektorit dhe diversitetin në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë. Ato janë nxjerrë nga përvojat e OSHC-ve në vendet respektive, lidhur me mjedisin ligjor, si dhe praktikën dhe sfidat me zbatimin e tij. Zhvillimi i parimeve, standardeve dhe indikatorëve është bërë duke pasur parasysh liritë dhe të drejtat e garantuara ndërkombëtarisht dhe praktikën më të mira të Bashkimit Evropian dhe vendeve të Evropës.

Fushat janë përcaktuar sipas parimeve kryesore të cilat janë përpunuar më tej në standarde specifike. Standardet janë shpjeguar dhe matur përmes indikatorëve, kjo për tu dhënë mundësinë OSHC-ve lokale, donatorëve ose palëve të tjera të interesuara për të rishikuar e monitoruar mjedisin ligjor dhe praktikën e zbatimit të tij. Matrica e plotë është në dispozicion në [www.monitoringmatrix.net](http://www.monitoringmatrix.net).

Përpunimi i Matricës së Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile ishte pjesë e një përpjekjeje të përbashkët të ekspertëve dhe OSHC-ve nga anëtarët dhe partnerët e rrjetit BCSDN si dhe me ekspertizë e mbështetje strategjike nga ECNL. Ekipi i ekspertëve me 11 anëtarë nga 10 vende të Ballkanit, përfshiu edhe një mori njohurish dhe eksperiencash specifike të OSHC-ve, si ligjore ashtu dhe praktike. Puna me Matricën përfshiu takime pune dhe online nga ekspertët, të cilat u shqyrtuan nëpërmjet fokus-grupeve të organizuara me aktorë të ndryshëm dhe konsultimeve publike.

## Mirënjohe

Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Raporti për Shqipërinë 2017 u përgatit në bashkëpunim dhe me mbështetjen bujare të OSHC-ve, ekspertëve dhe individëve.

Partnerët Shqipëri dëshiron t'i shprehë mirënjohjen drejtorëve ekzekutivë dhe përfaqësuesve të

OSHC-ve, të cilët morën pjesë në konsultime për bashkëpunimin, kontributin dhe kohën e tyre.

Partnerët Shqipëri falenderon për bashkëpunimin dhe korrektësinë institucionet publike që iu përgjigjën kërkesave për informacion të Partnerëve Shqipëri.

## III. Metodologjia

### Përmbledhje e përjasjes metodologjike

Për përgatitjen e Raportit të Matricës së Monitorimit për vitin 2017, Partnerët Shqipëri përdori një sërë instrumentash metodologjikë, duke përfshirë hulumtim në literaturë, përjasjen me pjesëmarrje në sigurimin e informacionit përmes takimeve konsultuese, intervista me menaxherë të OSHC-ve etj. Qëllimi ishte monitorimi i legjislacionit dhe indikatorëve të praktikës për të identifikuar progresin ose regresin e mjedisit mundësues duke përfshirë klimën e përgjithshme, legjislacionin dhe zbatimin e tij efektiv për veprimtarinë e OSHC-ve në Shqipëri.

Metodat për përgatitjen e Raportit të Matricës së Monitorimit 2017 janë si më poshtë:

#### Hulumtim literature

Duke pasur parasysh që Matrica e Monitorimit përmban indikatorë për vlerësimin e legjislacionit rreth praktikës, shqyrtimi i literaturës u realizua përmes:

**Rishikimi i Legjislacionit** - me qëllim të monitorimit të kuadrit ligjor dhe të rregulloreve të hartuara dhe të aprovuara gjatë vitit 2017 për një mjedis mundësues për OSHC-të. Ai përfshiu një rishikim dhe analizë të legjislacionit shqiptar (duke përfshirë zbatimin e rregulloreve), si dhe analiza mbi zbatimin e konventave dhe rregulloreve ndërkombëtare të miratuara nga shteti shqiptar.

**Rishikimi i praktikës bazuar në të dhënat dytësore, siç janë:** raporte të mediave; raportet e progresit të përgatitura nga donatorët, organizatat ndërkombëtare dhe agjencitë kombëtare - me qëllim identifikimin e zbatimit të legjislacionit në praktikë.

#### Kërkesat zyrtare për informacion nga institucionet publike

Për shkak të mungesës së të dhënave zyrtare të bëra publike, Partnerët Shqipëri dërgoi kërkesa zyrtare ministrive lidhur me konsultimet publike dhe mbështetjen financiare dhe jofinanciare që u është ofruar OSHC-ve. Kërkesa zyrtare për informacion u janë dërguar edhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Tiranës si dhe Administratës Tatimore mbi numrin e organizatave të regjistruara në vitin 2017 si dhe të dhëna të tjera lidhur me sektorin.

#### Pjesmarrja e komunitetit të OSHC-ve

Partnerët Shqipëri përdori bazën e saj të të dhënave për të informuar dhe ftuar OSHC-të të marrin pjesë në takimet konsultuese të organizuara për tema të ndryshme dhe që kontribuan në përgatitjen e Raportit të Matricës së Monitorimit 2017. Të gjitha gjetjet për treguesit e praktikës janë bazuar në informacionin dhe komentet e dhëna nga OSHC-të që morën pjesë në studim mbi zbatimin e kuadrit ligjor.

## IV. Gjetje dhe rekomandime

### Fusha 1: Garancitë Themelore Juridike të Lirive

#### Nën-fusha 1.1. Liria e organizimit

Liria e organizimit, si një e drejtë kushtetuese, është e garantuar dhe e rregulluar brenda kuadrit ligjor dhe ushtrohet lirisht nga individët apo personat juridikë për të krijuar apo marrë pjesë në organizata. Të gjithë individët dhe personat juridikë pa dallim, pavarësisht nga kombësia, gjinia, mosha etj, mund të themelojnë dhe/ose të marrin pjesë në organizata të ndryshme.

Kuadri ligjor dhe procedurat lidhur me regjistrimin e OSHC-ve në Shqipëri nuk ndryshuan gjatë vitit 2017, edhe pse “Kuadri legjislativ për regjistrimin dhe punën e OSHC-ve” ishte një nga fushat prioritare të Udhërrëfyesit për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Shoqërinë Civile. Veprimet e propozuara në Udhërrëfyes nuk janë ndërmarrë gjatë kësaj periudhe sa i përket regjistrimit të OSHC-ve, edhe pse sektori e ka adresuar jo pak herë këtë çështje. Krijimi i një regjistri elektronik të organizatave jofitimprurëse nga ana tjetër, ende nuk është zhvilluar. Ai jo vetëm që do të siguronte informacione të sakta për sektorin, por do të lejonte trajtimin e diferencuar tatimor të OSHC-ve në përputhje me natyrën e tyre jo-fitimprurëse dhe llojin e aktiviteteve. Kjo bazë të dhënash do të mundësonte gjithashtu matjen e ndikimit dhe kontributin e sektorit në zhvillimin ekonomik të vendit.

Problemet që kanë të bëjnë me decentralizimin, një process adekuat regjistrimi, së bashku me mungesën e të dhënave të sakta në një regjistër të dedikuar pengojnë sigurimin e një pamjeje të qartë dhe të saktë të të gjithë sektorit. Sipas të

dhënave zyrtare për vitin 2017<sup>3</sup>, 345 OSHC të reja janë regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Tiranës (198 Shoqata, 61 Fondacione dhe 86 Qendra), ndërsa vetëm 238 janë regjistruar për të njëjtën periudhë në Administratën Tatimore.

Kuadri ligjor aktual i lejon organizatat jofitimprurëse të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në mënyrë të pavarur dhe pa ndërhyrje nga shteti. Marrëdhëniet e organizatave jofitimprurëse me institucionet shtetërore kanë ndryshuar gjatë vitit të kaluar sa i përket procesit të kontrollit tatimor dhe çështjeve që lidhen me raportimin dhe apelimin. Miratimi i standardit të ri të kontabilitetit për organizatat jofitimprurëse deri në vitin 2016, krijoi lehtësira për OSHC-të sa i përket raportimit tek autoritetet shtetërore, ndërkohë që interpretimi i saj nga autoritetet tatimore mbetet një problem në të gjithë vendin.

Organizatave jofitimprurëse i nënshtrohen “kontrollit operacional” dhe “kontrollit kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” nga autoritetet tatimore. I pari bëhet nga inspektorët rajonalë të administratës tatimore, ndërsa tjetri, bëhet nga inspektorët rajonalë në bashkëpunim me inspektorët e drejtorisë së hetimit tatimor, që duke filluar nga viti 2017 janë nën varësinë e drejtpërdrejtë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Sipas ndryshimeve të prezantuara në Ligjin për Procedurat Tatimore në vitin 2016, tatimpaguesit duhet të njoftohen të paktën 30 ditë para fillimit të një kontrolli të plotë dhe rreth 10 ditë para vizitës fiskale. Rregullorja e re e ka përmirësuar ndjeshëm mënyrën e vjetër të kryerjes së kontrolleve krahasuar me vitet e kaluara, kur ato kryheshin pa njoftim paraprak dhe në mënyrë abuzive. Edhe pse Administrata Tatimore ka zhvilluar metodologji të re automatike

<sup>3</sup> Trajtimi Fiskal i OJF-ve / Partnerët Shqipëri, 2017  
Link: <http://partnersalbania.org/publication/trajtimi-fiskal-i-ojf-ve-vleresim-i-legjislacionit-dhe-praktikes-per-organizatat-jo-fitimprurëse-ne-shqiperi/>

të analizës së riskut sa i përket përzgjedhjes së tatimpaguesve për kontroll, rezultatet e saj për sektorin mund të mos jenë të sakta, kjo pasi regjistri elektronik i organizatave jofitimprurëse të administruara nga DPT është i pasaktë dhe shumë kompleks, duke përfshirë entitete të tjera si universitetet, partitë politike, etj.

Gjatë konsultimeve me OSHC-të, ato kanë raportuar të kenë qenë subjekt i kontrolleve të shpeshtanga inspektorët tatimorë gjatë aksioneve në kuadër të “luftës ndaj informalitetit” të iniciuar nga qeveria. Edhe pse ka pasur një përmirësim të ndjeshëm të sjelljes dhe komunikimit nga inspektorët, akoma mbeten për tu trajtuar problematikat e vazhdueshme si: ndryshimi i shpeshtë i inspektorëve në drejtoritë rajonale tatimore, interpretimi i ndryshëm i të njëjtës bazë ligjore nga rajone të ndryshme (ndonjëherë edhe brenda të njëjtës drejtori rajonale ka interpretime të ndryshme), mungesa e të kuptuarit të natyrës jo-fitimprurëse të OSHC-ve dhe tendenca e punonjësve publikë për të trajtuar sektorin njësoj si bizneset. Duke marrë parasysh problematikat e sipërpërmendura, lidhur këto edhe me dështimin për të përmbushur kërkesat e raportimit, shumë OSHC kanë qenë subjekt i sanksioneve duke sjellë si pasojë një rritje të konsiderueshme të detyrimeve të tyre ndaj autoriteteve tatimore<sup>4</sup>.

OSHC-të kanë të drejtë të **apelojnë vendimet administrative** në një organ apelimi, bazuar në Ligjin 9920, “Për Procedurat Tatimore”. Në rast se një organizatë e konsideron vendimin e organit tatimor të padrejtë, ajo duhet të ankimojë zyrtarisht aktin administrativ brenda 30 ditëve nga marrja e tij në Drejtorinë e Apelit Tatimor, i cili funksionon nën Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë që nga janari 2017. Organizata jofitimprurëse, njësoj si biznesi, duhet të plotësojë një nga kushtet e përcaktuara në Ligjin për Procedurat Tatimore që janë: parapagimi i shumës totale të tatimit të vlerësuar në aktin administrativ, ose lëshimi i një garancie bankare që mbulon të gjitha detyrimet dhe interesat. Gjobat dhe penalitetet nuk mund të parapagohen apo të sigurohen me garanci bankare. Drejtoria e Apelit Tatimor ka të drejtë të refuzojë shqyrtimin e ankesës zyrtare, nëse një nga kushtet e sipërpërmendura nuk është plotësuar. Kushti për të parapaguar detyrimet është në fakt një barrë për OSHC-të që nuk i sigurojnë dot mjetet financiare, duke penalizuar kështu sektorin

për të ushtruar të drejtën e apelit të vendimeve administrative.

OSHC-të mund të kërkojnë dhe sigurojnë lirisht burime të ndryshme financiare, vendase apo të huaja, për të mbështetur aktivitetet e tyre. Ligjërisht, ato mund të financohen nga kuotat e anëtarësisë, grantet dhe dhurimet. Organizatat gjithashtu mund të kryejnë veprimtari ekonomike nëse përmbushin kushtet e parashikuara në kuadrin ligjor aktual. Duke qenë se **grantet nga donatorët e huaj** mbeten burimi kryesor i financimit për OSHC-të, regjistrimi në Gjykatë dhe më pas në Administratën Tatimore, si kushte për hapjen e një llogarie bankare për lëvrimin dhe përdorimin e fondeve, kufizon lirinë e organizimit dhe ushtrimin e veprimtarisë së organizatave. OSHC-të kanë të drejtë të kryejnë **aktivitete për ngritje fondesh** në përmbushje të qëllimeve dhe objektivave të veprimtarisë së tyre ose për të mbështetur qëllimet dhe aktivitetet e organizatave të tjera jo-fitimprurëse, por legjislacioni në fuqi nuk ofron lehtësira për dhurimet e individëve apo kompanive, dhe aktiviteti filantropik nuk njihet akoma në kuadrin ligjor. Për sa i përket **fondeve publike**, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) është institucioni kryesor publik që ofron mbështetje financiare gjatë gjithë vitit, ndërkohë që është e vështirë të gjesh informacionin e saktë për mbështetje financiare të alokuar për OSHC-të nga institucionet e tjera shtetërore (qendrore apo lokale qofshin ato). OSHC-të kanë të drejtën ligjore për të marrë pjesë në procedurat e tenderimit, prokurimit publik, kontraktimit dhe transaksioneve të shitjes nga organet shtetërore, por për shkak të barrierave të paraqitura nga kuadri ligjor në fuqi dhe zbatimit të tij në praktikë, financime të kësaj natyre janë tejet të kufizuara. OSHC-të gjithashtu mund të kryejnë **aktivitete ekonomike** për të gjeneruar të ardhura në mbështetje të misionit të tyre. Shumë OSHC vitet e fundit kanë konsideruar ofrimin e shërbimeve kundrejt pagesës, ndaj Partnerët Shqipëri po ofron programe trajnimi dhe konsulence në ndihmë të OSHC-ve në mënyrë që të zhvillojnë modelet e tyre të biznesit e të angazhohen në aktivitete ekonomike. Nuk ka informacion zyrtar mbi numrin e OSHC-ve që kryejnë veprimtari ekonomike, edhe pse Autoritetet Tatimore kanë përgjegjësinë të mbajnë një regjistër të veçantë për organizatat jofitimprurëse, dhe sidomos për ato që kryejnë veprimtari ekonomike.

<sup>4</sup> Trajtimi Fiskal i OJF-ve / Partnerët Shqipëri, 2017



Nën-fusha 1.1., reflekton gjithashtu vlerësimin e indikatorëve të mëposhtëm të **Udhëzimeve të Bashkimit Evropian për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në Vendet e Zgjerimit, 2014-2020**

### 1.1.b. Vlerësimi i cilësisë së legjislacionit ekzistues dhe kornizës së politikës

- Janë identifikuar të gjitha boshllëqet në legjislacionin kombëtar dhe kornizën e politikës në lidhje me regjistrimin e OSHC-ve.
- Procesi i regjistrimit ende tejkalon periudhën prej 15 ditësh si periudhë maksimale e përcaktuar me ligj.
- Centralizimi i procesit të regjistrimit mbetet sfida kryesore e paraqitur në kuadrin ligjor ekzistues për regjistrimin e OSHC-ve.

### 1.1. c. Progresi me miratimin dhe zbatimin e legjislacionit relevant

- Nuk ka progres mbi adaptimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës në lidhje me regjistrimin, ndërprerjen dhe shpërbërjen e OSHC-ve.

### 1.3.a. Cilësia e mjedisit të favorshëm për organizatat bazë

- Organizatat me bazë komunitare nuk njihen si një lloj i veçantë OSHC në kuadrin ligjor në Shqipëri, ndaj nuk ka politika të veçanta dhe rregulla të aplikuara për këtë lloj organizatash. Mjedi ekzistues ndikon në mënyrë të barabartë të gjitha OSHC-të.

### 2.1.a. Perceptimi i OShC-ve lidhur me lehtësinë dhe efikasitetin e rregullave financiare dhe kërkesat raportuese (të zërthyera sipas llojit / madhësisë së OShC-ve)

- Miratimi i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat Jofitimprurëse në vitin 2016, ka përmirësuar perceptimin e OSHC-ve mbi kërkesat për raportimin.

### 2.1.b. Vlerësimi cilësor i rregullave financiare (me fokus mbi mekanizmat e ndërtuar që rregullat dhe obligimet financiare të ndryshojnë me ndryshimin e të ardhurave dhe aktiviteteteve jokomerciale)

- Standardi Kombëtar i Kontabilitetit për Organizatat Jofitimprurëse prezanton në mënyrë të thjeshtëzuar rregullat dhe kërkesat e raportimit për organizatat me të ardhura vjetore nën 5 milion Lekë (rreth 35,700 Euro).

## Nën-fusha 1.2 Liritë e tjera

E drejta për tubime paqësore garantohet nga Kushtetuta Shqiptare dhe legjislacioni në fuqi. Ligji primar që rregullon lirinë për tubime është Ligji nr. 8773, datë 23.4.2001 "Për Tubimet", i cili nuk ka ndryshuar që nga miratimi i tij në vitin 2001. Ligji siguron lirinë e tubimit paqësor për të gjithë, në përputhje me direktivat e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (ECHR). Në përgjithësi, ligji vlerësohet pozitivisht, por ka disa çështje që duhet të adresohen përmes ndryshimeve në ligj për të siguruar plotësisht lirinë e tubimit dhe për të qenë në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Një nga

problematikat kryesore është konfuzioni i krijuar ndërmjet termave **njoftim** dhe **leje** të përdorura në ligj mbi organizimin e tubimeve në sheshe dhe në vendkalime publike. Ndonëse në Ligjin për Tubimet thuhet se organizatorët duhet të **njoftojnë** me shkrim Policinë e Shtetit, në Kodin Penal organizimi i tubimeve **pa leje** nga organi kompetent përbën **kundravajtje penale**. Tubimet spontane (pa njoftim paraprak tek autoritetet publike) dhe kundër-protestat nuk përdoren dhe nuk njihen si koncepte në ligj, duke mos siguruar kështu mbrojtjen e qytetarëve që organizojnë dhe marrin pjesë në këto tubime, siç edhe parashikohet



në standardet ndërkombëtare për lirinë e tubimit. Roli i institucioneve vendore është gjithashtu një çështje që duhet të përcaktohet qartë në ligj, pasi praktika tregon se në disa raste ato paraqesin kërkesa të tepërta për organizatorët e tubimeve të cilat jo vetëm tejkalojnë kërkesat në ligj, por bien ndesh në mënyrë flagrante edhe me standardet dhe udhëzimet ndërkombëtare për lirinë e tubimeve<sup>5</sup>.

Tubimet e viteve të fundit kanë qenë kryesisht të udhëhequra nga pakënaqësia ndaj qeverisë dhe performancës së institucioneve publike, duke adresuar mungesën e transparencës dhe llogaridhënies së këtyre autoriteteve publike për të kryer dhe ofruar shërbime publike, duke e parë punën e tyre të ekspozuar ndaj praktikave korruptive. Tubimet më të shpeshta, veçanërisht ato të organizuara nga organizatat e shoqërisë civile kanë qenë të lidhura me fushat e tyre të punës dhe përpjekjet e tyre advokuese<sup>6</sup>. Shqetësimet kryesore të ngritura nëpërmjet këtyre tubimeve kanë qenë të lidhura kryesisht me mbrojtjen e mjedisit dhe zonave të gjelbra, çështjet sociale dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Shoqëria civile ka qenë më e angazhuar dhe më e organizuar në shprehjen e shqetësimeve për çështje të ndryshme socio-politike. Protestat kundër hidrocentraleve në lumenjtë e Valbonës dhe Vjosës, apo kundërshtimi ndaj importeve të mbeturinave, dallojnë si shembuj të mirë. Gjatë dy viteve të fundit, shumë nga tubimet e organizuara nga organizatat e shoqërisë civile (OSHC) janë mbuluar disi mediatikisht, kryesisht ato të organizuara për të drejtat e grave dhe fëmijëve si dhe për mbrojtjen e mjedisit<sup>7</sup>.

Qeveria nuk vendos asnjë kufizim për përdorimin e medias sociale dhe organizatorët/pjesëmarrësit mund ta përdorin atë para, gjatë dhe pas organizimit të tubimit. Mbulimi mediatik i protestave në përgjithësi është konsideruar neutral, por sipërfaqësor. Raportimet e medias rrallë thellohen në trajtimin e çështjeve për të cilat organizohen protestat, duke u kujdesur më shumë për të qenë "politikisht korrekt", në vend të raportimeve që do të jepnin një pamje të plotë

të dinamikave dhe arsyeve të protestave si dhe adresimin e problemeve themelore të tyre<sup>8</sup>. Në përgjithësi nuk ka kufizime për mbrojtësit e të drejtave të njeriut dhe institucione të tjera monitoruese për të marrë pjesë dhe për të vëzhguar lirinë e tubimeve në Shqipëri.

Sa i përket paraburgimit, ndjekjes penale dhe llogaridhënies së agjencive / institucioneve që janë të përfshira në tubime, duhet të ketë më shumë informacion në dispozicion të publikut me raste që do të mundësonin një kuptim më të qartë të rolit të tyre.

Liria e shprehjes si e drejtë themelore garantohet nga Kushtetuta Shqiptare. Nga konsultimet me OSHC-të nuk janë raportuar raste të kufizimit të të drejtës së shprehjes. Renditja e përgjithshme e Shqipërisë në raportin e Freedom House<sup>9</sup> për vitin 2017 krahasuar me një vit më parë nuk ka ndryshuar, por theksohet se mediat kanë kufizime të së drejtës së shprehjes kryesisht për shkak të ndikimeve politike apo bizneseve të fuqishme.

Edhe për vitin 2017, liria e përdorimit të platformave të ndryshme të internetit nuk pati kufizim nga ndonjë autoritet shtetëror. Gjatë takimeve dhe konsultimeve me OSHC gjatë gjithë vitit, nuk u raportua të ketë ndonjë ndalim apo kufizim të komunikimit.

Bazuar në sa më sipër, në mënyrë që qytetarët dhe OSHC-të të gëzojnë plotësisht lirinë për tubime paqësore, lirinë e shprehjes dhe liritë e tjera, rekomandohet ndryshimi dhe përmirësimi i ligjit për tubimet në përputhje me standardet ndërkombëtare. Përmirësimet janë të nevojshme në nivel ligjor sa i përket njohjes së tubimeve spontane dhe kundër-demonstratave, komunikimit me autoritetet përgjegjëse që janë të përfshira në faza të ndryshme të procesit të mundësimit të tubimit dhe qartësimin të procedurave të ankimimit që duhet të ndiqen në rastet kur organizatorët ndjehen të dhunuar për të ushtruar të drejtat e tyre<sup>10</sup>. Përveç kësaj, është i nevojshëm edukimi dhe informimi i OSHC-ve mbi kërkesat e ligjit për organizimin e tubimeve paqësore, mbi detyrat dhe përgjegjësitë e organizatorëve, për të shmangur

<sup>5</sup> Monitorimi i të drejtës për tubime paqësore – Raporti për Shqipërinë 2016-2017, Partnerët Shqipëri, 2017

<sup>6</sup> USAID 2017, Indeksi i Qëndrueshmërisë së OSHC-ve 2016 për Evropën Qendrore dhe Lindore dhe Euroazinë. Fq. 32

<sup>7</sup> USAID 2017, Indeksi i Qëndrueshmërisë së OSHC-ve 2016 për Evropën Qendrore dhe Lindore dhe Euroazinë. Fq. 30

<sup>8</sup> [http://www.media.ba/sites/default/files/policy\\_brief\\_albania.pdf](http://www.media.ba/sites/default/files/policy_brief_albania.pdf)

<sup>9</sup> Liria në Botë 2018: Link <https://freedomhouse.org/report/freedom-world/2018/albania>

<sup>10</sup> Monitorimi i të drejtës për tubime paqësore – Raporti për Shqipërinë 2016-2017, Partnerët Shqipëri, 2017

kështu refuzimin e të drejtës për tubime paqësore si dhe konfrontime të mundshme me policinë e shtetit apo autoritete të tjera publike.

Vlerësimi i Standartit 1, të Nën-fushës 1.2., reflekton gjithashtu vlerësimin e indikatorëve të mëposhtëm të **Udhëzimeve të Bashkimit Evropian për Mbështetjen e Shoqërinë Civile në Vendet e Zgjerimit, 2014-2020**

Gjetjet bazuar në objektivat për secilin tregues janë:

#### 1.1.b. Vlerësimi i cilësisë së legjislacionit ekzistues dhe kornizës së politikës

- Kuadri ligjor aktual garanton lirinë e organizimit, tubimit dhe shprehjes, për të gjithë individët dhe personat juridikë.
- Përmirësimet janë të nevojshme në nivel legjislativ sa i përket pasjes së lejes për të organizuar një tubim, njohjes së tubimeve spontane dhe kundër-demonstratave, komunikimit me autoritetet përgjegjëse që janë të përfshira në faza të ndryshme të procesit të mundësimit të tubimit dhe qartësimit të procedurave të ankimimit që duhet të ndiqen në rastet kur organizatorët ndjehen të dhunuar për të ushtruar të drejtat e tyre.
- Roli i institucioneve vendore është gjithashtu një çështje që duhet të përcaktohet qartë në ligj, pasi praktika tregon se në disa raste ato paraqesin kërkesa të tepërta për organizatorët e tubimeve të cilat jo vetëm tejkalojnë kërkesat në ligj, por bien ndesh në mënyrë flagrante edhe me standardet dhe udhëzimet ndërkombëtare për tubimet paqësore.

#### 1.1.c. Progresi me miratimin dhe zbatimin e legjislacionit relevant

- Në vitet e fundit, nuk ka pasur ndryshime në ligjin që rregullon lirinë e tubimit në Shqipëri, përkatësisht Ligji nr. 8773, datë 23.4.2001 "Për Tubimet".
- Ka pasur përmirësime në administrimin e tubimeve, ruajtjen e rendit publik gjatë organizimit të tyre dhe respektimin e lirisë së tubimeve nga ana e policisë së shtetit në vitin 2017.

## Fusha 2: Kuadri për Qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat Financiare për OSHC-të

### Nën-fusha 2.1 Trajtimi tatimor/fiskal për OSHC-të dhe donatorët e tyre

Legjislacioni fiskal nuk pati ndonjë përmirësim gjatë vitit 2017 sa i përket trajtimit të OSHC-ve. Sektori varet nga donacionet e huaja, ndërkohë që stimujt për dhurime nga individët apo kompanitë ende nuk janë parashikuar në kuadrin ligjor.

Sektori, pavarësisht se njihet si jo-fitimprurës, ka qenë dhe vazhdon të jetë pjesë e skemës së TVSH-së. Për shkak të disa keqinterpretimeve të ligjit si dhe iniciativave të dobëta për të rregulluar trajtimin e TVSH-së, një numër i madh i OSHC-ve

janë regjistruar automatikisht në TVSH<sup>11</sup> duke filluar nga viti 2008 deri në 2014, pas miratimit të një udhëzimi të Ministrit të Financave për aplikimin e TVSH-së për sektorin.

Megjithëse situata ndryshoi në vitin 2015, 60% e sektorit mbetet ende e regjistruar në skemën e TVSH-së. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve raporton se ka çregjistruar nga TVSH-ja të paktën 35 OSHC për periudhën 2016-2017, duke iu referuar ligjit për TVSH-në dhe udhëzimit<sup>12</sup>.

<sup>11</sup> Sipas të dhënave nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, rreth 1,348 OSHC (shumica e të cilave janë regjistruar automatikisht në periudhën 2008 - 2014 kur ligji i ri i TVSH-së dhe rregulloret shtesë u miratuan) aktualisht janë objekt i TVSH-së, ndërsa numri i OSHC-ve që ushtrojnë veprimtari ekonomike është i papërfillshëm.

<sup>12</sup> Neni. 122 i Ligjit. 92/2014 dhe neni. 6 i Udhëzimit nr. 6, datë 30.01.2015

Megjithatë, ekziston një kontradiktë në atë që DPT raporton me parashikimin që jep ligji<sup>13</sup> në lidhje me çregjistrimin e TVSH-së, i konfirmuar edhe nga konsultimet me përfaqësuesit e sektorit.

Është evidente që nuk ka asnjë bazë ligjore për çregjistrimin nga TVSH-ja e OSHC-ve që nuk kanë kryer aktivitet ekonomik dhe janë regjistruar automatikisht nga zyrat e taksave, prandaj është domosdoshmëri hartimi i ndryshimeve në kuadrin ligjor dhe miratimi i procedurave të veçanta për çregjistrimin nga TVSH-ja e këtij segmenti të sektorit. Rregullorja dhe procedura e re duhet të shkojnë paralelisht me zhvillimin e manualeve specifike që do të shërbejnë si një dokument orientimi për inspektorët tatimorë, OSHC-të dhe çdo palë të interesuar për aplikimin e procedurës së re. Programet e përbashkëta të trajnimit të sektorit dhe punonjësve tatimorë janë gjithashtu të domosdoshme në mënyrë që të dy palët të qartësojnë çështjet dhe të sigurojnë zbatimin e saj korrekt.

Grantet, kuotizacionet dhe dhurimet janë të përjashtuara nga tatimi, ndërkohë aktiviteti ekonomik i OSHC-ve tatóhet sipas legjislacionit në fuqi. Njëlloj si biznesi, organizatat e shoqërisë civile konsiderohen subjekte të tatueshme dhe duhet të dorëzojnë çdo muaj deklaratën e TVSH-së (edhe kur shuma është zero) si dhe librat e blerjeve dhe shitjeve për të gjitha transaksionet e bëra gjatë periudhës tatimore. Ka pak lehtësira të parashikuara në legjislacionin aktual sa i përket veprimtarisë ekonomike të OSHC-ve. Të ardhurat vjetore nga aktiviteti ekonomik nuk duhet të kalojnë 20% të ardhurave totale dhe nëse kjo

<sup>13</sup> Neni 122 i Ligjit nr. 92/2014 për "Tatimin mbi Vlerën e Shtuar" i referohet biznesit të vogël që kërkon pranë autoriteteve tatimore çregjistrim nga TVSH kur qarkullimi i tij në 12 muajt kalendarik të fundit bie nën kufirin minimal të regjistrimit për TVSH.

- Neni nr. 6, pika c) të Udhëzimit nr. 6 datë 30.01.2015 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar", i referohet rasteve kur një "person i tatueshëm" i regjistruar për TVSH nuk ka qenë kurrë i detyruar të regjistrohet dhe as nuk ka ushtruar vullnetarisht të drejtën për t'u regjistruar për TVSH. Sipas të njëjtit nen, njësia ekonomike mund të çregjistrohet pasi të jetë konstatuar se ajo as nuk ka qenë e detyruar dhe as vullnetarisht nuk ka ushtruar të drejtën për t'u regjistruar për TVSH, e megjithatë është ende përgjegjëse për kryerjen e deklaramit dhe pagesës së TVSH-së që nga momenti që është regjistruar deri në datën e çregjistrimit nga TVSH.

- Duke iu referuar nenit 8 të të njëjtit udhëzim, një kontradiktë tjetër që vihet re është se OSHC-të nuk kualifikohen si "person i tatueshëm" përveçse në rastet kur ato kryejnë veprimtari ekonomike të vazhdueshme, dhe në këtë rast i referohemi vetëm organizatave që nuk kanë kryer asnjë veprimtari ekonomike dhe janë regjistruar automatikisht në TVSH.

shumë e tejkalon kufirin e regjistrimit të TVSH-së, atëherë OSHC duhet të regjistrohet për TVSH.

Sipas Ligjit për Procedurat Tatimore, subjektet që kryejnë veprimtari ekonomike dhe kanë qarkullim vjetor prej më shumë se 2 milionë lekë (rreth 15,000 euro), duhet të regjistrojnë dhe të deklarojnë TVSH-në duke filluar nga muaji prill 2018. Megjithëse kuadri ligjor i lejon OSHC-të të kërkojnë rimbursimin e TVSH-së, kjo është praktikisht e pamundur<sup>14</sup>, pasi për shkak të karakterit jo të vazhdueshëm të veprimtarisë së OSHC-ve, ato nuk mund të përmbushin dy kushtet bazë për të kërkuar rimbursim: (1) tepricë kreditore e mbartur për tre muajt të njëpasnjëshëm (2) shuma e kërkuar për rimbursim duhet të kalojë 400,000 Lekë (rreth 3,000 Euro). E njëjta situatë është edhe me përjashtimin nga TVSH-ja për aktivitetet e konsideruara si "aktivitete me interes të përgjithshëm" nga ligji për TVSH-në.

Për të përfituar përjashtimin nga TVSH-ja për këto lloje aktivitetesh, OSHC-të duhet të plotësojnë të gjitha kushtet e parashikuara në rregulloren përkatëse<sup>15</sup>. Edhe kjo përpjekje për të lehtësuar sektorin nuk ka pasur asnjë rezultat, pasi procedura është e tejkëqitur në kohë dhe nuk është e zbatueshme nga organizatat. Pas kërkesës për informacion në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, nuk është marrë asnjë përgjigje lidhur me numrin e OSHC-ve që kanë aplikuar dhe përfituar nga përjashtimi. Reagimi i OSHC-ve në lidhje me ligjin është po ashtu kritik, kjo pasi edhe fusha e "aktiviteteve me interes të përgjithshëm" të parashikuara me ligj është shumë e kufizuar.

Sa i përket taksave vendore, nuk ka një trajtim të diferencuar për OSHC-të, duke marrë parasysh natyrën e tyre jofitimprurëse, misionin, mënyrat e financimit, aktivitetet dhe përfituesit. OSHC-të, njësoj si bizneset e vogla janë subjekt i të njëjtit nivel taksash/tarifash pothuaj në të gjitha bashkitë, e në shumicën e rasteve kryesisht trajtohen si subjekte tregtare<sup>16</sup>.

Siç theksohet edhe në seksionet e mëparshme, burimi kryesor i financimit të sektorit është nga grantet e donatorëve të huaj. Grantet dhe donacionet janë të përjashtuara nga TVSH-ja dhe në kuadër të disa marrëveshjeve financiare apo

<sup>14</sup> Nuk ka pasur asnjë rast rimbursimi të TVSH-së për OSHC-të nga Administrata Tatimore për vitin 2017 sipas informacioneve zyrtare të DPT.

<sup>15</sup> Vendim i Këshillit të Ministrave No. 953, datë 29.12.2014 "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 92/2014".

<sup>16</sup> Trajtimi Fiskal i OJF-ve, Partnerët Shqipëri

granteve të ratifikuara nga Parlamenti Shqiptar dhe Këshilli i Ministrave, është parashikuar mos shfrytëzimi i burimeve financiare të huaja për të paguar taksat. Sipas këtyre marrëveshjeve, tatimi mbi vlerën e shtuar i paguar rimbursohet për donatorët e huaj nga Thesari brenda 30 ditëve, sipas rregullave dhe procedurës<sup>17</sup>, përcaktuar me vendim të Ministrit të Financave. Për projektet e financuara përmes Instrumentit të Parazgjerimit (IPA), ekziston një udhëzim i Ministrisë së Financave i nxjerrë në vitin 2013 për rimbursimin e TVSH-së, ndërsa rimbursimi i TVSH-së për instrumente të tjerë të financimit të BE-së në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar (siç janë EIDHR, IPA ndërkufitare, Erasmus +, etj.) nuk është i parashikuar. Kontraktorët (organizatat jofitimprurëse) e projekteve të financuara nga fondet IPA do të rimbursohen nga Administrata Tatimore për TVSH-në e paguar për mallrat ose shërbimet e furnizuara në kuadër të këtyre projekteve, pas dorëzimit të kërkesës për rimbursim të TVSH-së dhe dokumenteve të tjera relevante siç parashikohet në këtë Udhëzim. Vetëm marrëveshja dhe udhëzimi në mbështetje të zbatimit të saj kanë rezultuar joefektive<sup>18</sup>, pasi deri më tani vetëm një organizatë është rimbursuar, sipas të dhënave zyrtare të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Një arsye për dështimin e skemës së rimbursimit të TVSH-së për fondet IPA është mungesa e një formati aplikimi të standardizuar, si dhe interpretimet e ndryshme të bëra ndaj udhëzimit nga zyrtarët tatimorë. Paqartësia në udhëzim ka sjellë si rezultat refuzimin e regjistrimit të projekteve për rimbursimin e TVSH-së nga autoritetet tatimore. Përveç kësaj, procedura e rimbursimit është tepër e gjatë dhe pengon qëndrueshmërinë financiare

<sup>17</sup> Vendimi i Ministrit të Financave është miratuar në bazë të nenit 26 të Ligjit nr. 9840, datë 10.12. "Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Evropiane, për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA)"

<sup>18</sup> Sipas informacionit zyrtar të Administratës Tatimore: vetëm 8 (tetë) Çertifikata Regjistrimi me qëllim rimbursimi të TVSH-së së financuar nga IPA janë lëshuar në periudhën 2015-2017 (hapi i parë i procedurës së rimbursimit të TVSH-së është regjistrimi i projektit në Drejtorinë Rajonale Tatimore dhe marrja e certifikatës për qëllimin e rimbursimit), vetëm 4 (katër) OSHC kanë aplikuar për rimbursim të TVSH-së (pas zbatimit të projektit, OSHC-ja i paraqet Autoritetet Tatimore kërkesën për rimbursimin e TVSH-së në lidhje me aktivitetet sipas kontratës si dhe dokumentet mbështetëse siç parashikohet në udhëzim). Tre aplikime të OSHC-ve për rimbursimin e TVSH-së, nga katër (4) janë refuzuar për mos përmbushjen e kriteve ligjore të parashikuara në udhëzim, sipas DPT.

të OSHC-ve që duhet të paguajnë një sasi të konsiderueshme të TVSH-së për mallrat dhe shërbimet e blera gjatë zbatimit të projektit nga burimet e tyre dhe të aplikojnë për rimbursimin e TVSH-së pas miratimit të raportit final nga Delegacioni Evropian, i cili mund të zgjasë deri në 18 (tetëmbëdhjetë) muaj pas zbatimit të projektit.

Gjatë vitit 2017, legjislacioni nuk siguroi ndonjë lehtësi apo stimul për individët dhe kompanitë që duan të dhurojnë ndonjë ligji për organizatat jofitimprurëse u jep të drejtën OSHC-ve për të marrë grante dhe donacione nga çdo person privat ose publik, shqiptar apo i huaj. Vetëm dhurimet në formë sponsorizimi nga kompanitë private njihen si shpenzime zbritëse rreth 3% deri 5% të fitimit para tatimit, të parashikuar në Ligjin për Sponsorizimet. Kjo zbritje njihet nga autoritetet tatimore pas verifikimeve të kontratës së sponsorizimit dhe provave të tjera lidhur me të. Kompanitë e huaja gjithashtu mund të aplikojnë për zbritje sipas ligjit në rast të sponsorizimit të OSHC-ve, vetëm nëse janë regjistruar më parë ligjërisht në institucionet shqiptare dhe gjithashtu do të duhet të ofrojnë provat dhe dokumentet e nevojshme. Edhe në rastin e sponsorizimit, kompanitë nuk aplikojnë për të përfituar ndonjë zbritje tatimore pasi ato rrezikojnë të penalizohen në vend që të stimulohen, pasi donacionet konsiderohen shpesh nga inspektorët tatimorë si një përpjekje për shmangie tatimore. Aktiviteti filantropik i individëve dhe kompanive nuk njihet apo rregullohet me ligj të veçantë; prandaj skemat e stimujve fiskalë lidhur me kontributin e tyre për OSHC-të janë jo-ekzistente. Promovimi dhe inkurajimi i aktivitetit filantropik si një kontribut në qëndrueshmërinë financiare të OSHC-ve, gjithashtu njihet si një nga fushat e zhvillimit në Udhërrëfyes. Gjatë punës që Partnerët Shqipëri kanë kryer në monitorimin e aktivitetit filantropik nga individët dhe bizneset private, vihet re se vlera totale e dhurimeve private për 2017 krahasuar me vitin e kaluar ka rënë, ndërkohë rastet e dhurimeve në numër janë rritur. Në 2016 individët mbanin numrin më të madh të dhurimeve, ndërsa për vitin 2017 kryesuan bizneset. Fusha kryesore e dhurimeve ishte Mbështetja e Grupeve të Margjinalizuara, ndryshe nga një vit më parë ku numri më i madh i dhurimeve shkoi në ndihmë të familjeve të varfra. Kanalet kryesore të dhurimeve janë: institucionet sociale (publike) me 171 raste ose 49% të dhurimeve, 76 raste ose 22% shkuan direkt tek Individit ose Familje,



ndërkohë vetëm 57 raste ose 16% janë kryer përmes OSHC-ve . Këto të dhëna konfirmojnë edhe një herë gjetjet e studimit të Partnerëve Shqipëri **Aktiviteti Filantropik i Ndërmarrjeve në Shqipëri 2016**, që bizneset private kërkojnë rritjen e transparencës dhe kapaciteteve nga OSHC-të në menaxhimin e donacioneve të tyre. Në këtë kontekst, rritja e dhurimeve individuale dhe të korporatave përmes OSHC-ve do të lidhen me njohjen e aktivitetit filantropik në kuadrin ligjor, rritjen e stimujve fiskale për donacionet

e korporatave dhe parashikimi i stimujve fiskalë edhe për individë dhurues. Nga ana tjetër, nevoja për rritjen e ndërgjegjësimit dhe kapaciteteve të inspektorëve tatimorë mbi aktivitetin filantropik dhe natyrën e aktiviteteve të OSHC-ve duhet të shkojë paralelisht me kuadrin e ri ligjor.

Krijimi i platformave bashkëpunuese midis OSHC-ve dhe sektorit privat është një faktor shtesë për të kontribuar në rritjen e volumit të donacioneve për OSHC-të.

Vlerësimi i Standardit 2, të Nën-fushës 2.2 reflekton gjithashtu vlerësimin e treguesve të mëposhtëm të **Udhëzimeve të Bashkimit Evropian për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në Vendet e Zgjerimit, 2014-2020**. Gjetjet bazuar në objektivat për secilin indikator janë:

### **2.2. a Numri dhe lloji i donacioneve për OShC-të, nga donatorë privatë dhe të korporatave (specifikuar në vlera monetare)**

- Të dhënat nga monitorimi i aktivitetit filantropik gjatë vitit 2017 në Shqipëri realizuar nga Partnerët Shqipëri tregojnë se janë 317 raste të dhurimeve gjithsej nga donatorë individë dhe biznese në shumën 48,715,121 Lekë, nga të cilat 57 raste dhurimesh janë kaluar tek OSHC-të. Dhuruesit kryesorë janë kompanitë (89 raste) dhe individët (89 raste) <sup>19</sup>.

### **2.2.b Cilësia dhe zbatueshmëria e zbritjes për donacionet individuale dhe të korporatave të përcaktuara me legjislacione dhe rregullore (përfshirë këtu zbrithimin në llojet e donacioneve që mund të zbriten)**

- Ligji Për Sponsorizimin është i vetmi ligj që siguron stimuj tatimorë për dhurimet e korporatave. Shuma e sponsorizimit njihet si shpenzim i zbritshëm nga 3% deri në 5% e fitimit para tatimit.
- Dhurimet nga individët nuk njihen nga ky ligj.
- Kuadri ligjor nuk është favorizues dhe nuk inkurajon për dhurimet individuale dhe të korporatave.

### **2.3.a Cilësia e sistemit të përfitimeve tatimore për aktivitetet operacionale dhe ekonomike të OSHC-ve.**

Sistemi i përfitimeve tatimore nuk konsiderohet efektiv për aktivitetin operacional dhe ekonomik të OSHC-ve.

- Ndryshimet në ligjin e ri për TVSH-në që hyri në fuqi në vitin 2015 nuk janë zbatuar me efikasitet lidhur me rimbursimin e TVSH-së për projektet e IPA-s apo donatorëve të tjerë.
- Çregjistrimi i OSHC-ve si entitet ligjor nga sistemi i TVSh-së njihet me ligjin e TVSh-së 2015 por nuk është i rregulluar nga akte normative të qarta, prandaj nevojiten ndryshime të menjëhershme.
- Prezantimi i procedurave përjashtuese nga TVSH-ja për aktivitetet e klasifikuara si “në interes të publikut” nuk funksionuan dhe shumë pak OSHC përfituan nga kjo. Procedura është e gjatë dhe jo shumë e qartë, gjë që ka krijuar hezitim në sektor për ta përdorur atë.
- Asnjë stimul për dhurimet e individëve apo kompanive nuk është parashikuar në ligj, gjatë vitit 2017.
- Të ardhurat nga aktiviteti ekonomik i lidhur me misionin e OSHC-ve deri në 20% të të ardhurave vjetore të OSHC-ve janë të përjashtuara nga TVSH.

<sup>19</sup> Aktiviteti Filantropik 2017, Partnerët Shqipëri <http://partnersalbania.org/News/fakte-mbi-aktivitetin-filantropik-ne-shqiperi-gjate-2017/>

## Nën-fusha 2.2 Mbështetja e shtetit

Bazuar në Ligjin nr. 112/2015 për Inspektimin Financiar Publik, **“Fondet publike”** janë të gjitha fondet, përfshirë fondet e Bashkimit Evropian dhe të donatorëve të tjerë, të cilat mbliidhen, arkëtohen, mbahen, shpërndahen dhe shpenzohen nga njësitë publike dhe që përbëhen nga të ardhurat, shpenzimet, kreditë dhe grantet për njësitë publike.

Bazuar në të dhënat zyrtare dhe hulumtimet e raporteve të ndryshme të institucioneve shtetërore, shifrat në lidhje me fondet publike të ndara për OSHC-të mbeten të dobëta. Është e pamundur të llogaritet shuma e saktë e fondeve publike që u shpërndahen OSHC-ve nga institucionet shtetërore, në nivel qendror apo vendor, pasi vetëm pak prej këtyre institucioneve publikojnë të dhëna. Gjatë monitorimit, Partnerët Shqipëri ka identifikuar disa institucione publike që kanë shpërndarë fonde publike në OSHC-të në 2017, si vijon:

**Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC):** Është mekanizmi kryesor në nivel kombëtar për shpërndarjen e fondeve publike për OSHC-të, me qëllim të mbështetjes së zhvillimit institucional të tyre, projekteve dhe bashkë-financimit të granteve të BE-së dhe të tjera. Fondet e alokuara në Buxhetin e Shtetit për Agjencinë për t’u shpërndarë OSHC-ve çdo vit është rreth 700,000 Euro (ose 100,000,000 Lekë). Bazuar në të dhënat e publikuara, AMSHC shpall mesatarisht një thirrje të hapur për projekt propozime në vit. Thirrja e hapur për propozime për vitin 2017 u shpall në janar dhe kishte dy komponentë kryesorë:

1. Projekte të financuara nga AMSHC
2. Projektet e bashkë-financuara nga AMSHC dhe donatorë të tjerë

Thirrja për propozime adresoi një gamë të gjerë fushash prioritare për t’u mbështetur: iniciativat që forcojnë kapacitetet e grupeve të marginalizuara (LGBTQI, pakicat, gratë, të papunët, paraplegjikët, të moshuarit etj.). Iniciativa për fuqizimin e shtetit ligjor (reforma në drejtësi, lufta kundër korrupsionit, barazia para ligjit, etj.), fuqizimi ekonomik i grave sipërmarrëse, të rinjve, grupeve të tjera të pafavorizuara etj. Në kuadër të kësaj thirrjeje janë dorëzuar gjithsej 124 aplikime, janë shpallur fitues 35 OSHC të cilët kanë marrë gjithsej 101 milionë Lekë (rreth

754,000 Euro). Shuma minimale e dhënë ishte 1,5 milionë Lekë (rreth 11,200 Euro), ndërsa shuma maksimale e dhënë ishte 4,5 milionë Lekë (rreth 33,600 euro)<sup>20</sup>.

Duke iu referuar informacionit të marrë nga Partnerët Shqipëri, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile raporton se ka ofruar mbështetje institucionale për 20 OSHC, nga 64 aplikime në total. Sidoqoftë, në faqen zyrtare të institucionit, sa i përket kësaj natyre të mbështetjes nuk është bërë asnjë thirrje për propozime në vitin 2017 dhe nuk ka informacion për organizatat që kanë përfituar mbështetje institucionale nga agjencia.

Një burim tjetër i fondeve publike për OSHC-të në vitin 2017 ka qenë **Ministria e Kulturës**<sup>21</sup>. Sipas informacionit zyrtar të marrë nga Ministria, 123 OSHC kanë marrë një total prej 157, 6 milionë Lekë (rreth 1, 1 milion Euro) nga 269 aplikime të paraqitura në total. Shuma minimale e dhënë ishte 200,000 Lekë (rreth 1,500 Euro), ndërsa shuma maksimale e dhënë ishte 1,6 milion Lekë (rreth 12,000 Euro). Ministria gjithashtu ka ofruar mbështetje jofinanciare për 43 OSHC si p.sh. përdorimi i hapësirave të Ministrisë, burimeve njerëzore dhe promovimi i aktiviteteve të tyre në mjetet e komunikimit të Ministrisë. Nuk ka të dhëna të publikuara për natyrën e projekteve, as emrat e fituesve të këtyre skemave

**Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara** ka mbështetur me fonde publike dy OSHC gjatë vitit 2017. Në përputhje me dispozitat e nenit 37 të ligjit shqiptar “Anti-Mafia”, 25 milionë Lekë (183,000 euro) janë ndarë nga Fondi i Posaçëm për Parandalimin e Kriminalitetit dhe Edukimin Ligjor<sup>22</sup>. Ky fond i posaçëm krijohet kur Agjencia merr në administrim pasuri të reja dhe mund të ndajë fonde për përdorimin e tyre nga organizatat e shoqërisë civile apo subjektet shtetërore. Në pesë vitet e fundit, me vendim të Ministrit të Financave, fondi u krijua vetëm për vitin 2013 dhe 2017. Vetëm 20% e fondit në dispozicion është ndarë për OSHC-të, ndërsa pjesa tjetër u është dhënë institucioneve shtetërore si: Prokuroria

<sup>20</sup> Me kërkesë zyrtare për informacion nga Partnerët Shqipëri për AMSHC

<sup>21</sup> Me kërkesë zyrtare për informacion nga Partnerët Shqipëri për Ministrinë e Kulturës

<sup>22</sup> Ligji nr. 10192, i vitit 2009 dhe i ndryshuar më 2017, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”

e Përgjithshme, Policia e Shtetit dhe Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit, ndonjëse ligji nuk parashikon ndonjë rregull mbi shpërndarjen e fondeve<sup>23</sup>. Në vitin 2016, në kuadrin e bashkëpunimit me Partnerët Shqipëri për zbatimin e projektit **C.A.U.S.E – Ripërdorimi i pronave të konfiskuara për sipërmarrje sociale**, një iniciativë inovative e financuar nga BE, Agjencia nisi një procedurë të re për ri-përdorimin social të pronave të konfiskuara për ndërmarrje sociale nga OSHC-të. Objektivi i përgjithshëm i projektit është përdorimi i qëndrueshëm i pasurive të konfiskuara dhe mbështetja e OSHC-ve në menaxhimin e pronave të konfiskuara. Nëpërmjet kësaj iniciative, të paktën dy prona të konfiskuara nga krimi i organizuar do të ripërdoren nga OSHC-të në kuadër të një kontrate hua-përdorjeje me Agjencinë për një periudhë prej së paku 5 vjetësh, për të zbatuar idetë e tyre të ndërmarrjeve sociale të financuara nga projekti. Kjo iniciativë do të shërbejë si model për t'u përdorur nga Agjencia për ripërdorim nga OSHC-të, të aseteve të konfiskuara nga krimi i organizuar, dhe transformimin e tyre në hapësira për komunitetet lokale për t'u përdorur për qëllime sociale, kulturore apo rehabilituese ku do të mund të përfitojnë komunitetet në tërësi.

**Fondi i Llotarisë Kombëtare** shpalli një thirrje për projekt propozime në vitin 2017. Shuma totale në dispozicion ishte 15,4 milion Lekë (rreth 115,000 Euro). Sipas informacionit të publikuar në faqen zyrtare të Llotarisë Kombëtare, vetëm një OSHC është shpallur fituese por nuk ka të dhëna për vlerën e mbështetjes financiare të dhënë për projektin<sup>24</sup>.

Sa i përket transparencës në shpërndarjen e fondeve publike, institucionet kanë mangësi në prodhimin dhe publikimin e informacionit. Kjo ka qenë dhe mbetet një nga çështjet më të diskutuara në shoqërinë civile. Përgjithësisht institucionet kanë rregulla dhe procedura lidhur me transparencën. Thirrjet publikohen në faqet zyrtare të institucioneve, por nuk ka informacion për projektet e shpallura fituese përveç statistikave në numër.

Në nivel lokal, një zhvillim i rëndësishëm në lidhje me shpërndarjen e fondeve publike për OSHC-të në vitin 2017 ishte shpallja e programit rajonal

<sup>23</sup> Me kërkesë zyrtare për informacion nga Partnerët Shqipëri për AAPSK

<sup>24</sup> <http://lotaria.al/kreu/ceshtjet-e-mira/>

për Demokraci Lokale në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD) i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga UNDP. Programi do të mbështesë 12 bashki (Shkodër, Lezhë, Elbasan, Durrës, Përmet, Korçë, Librazhd, Tropojë, Tiranë, Roskovec, Dibër dhe Prrenjas) nëpërmjet një granti prej 1,130,952 Euro, nga të cilat 80% është kontribut i Programit dhe 20 % kontribut i bashkive në një periudhë tre vjeçare. Rreth 100 projekte të zbatuara nga organizatat e shoqërisë civile (OSHC) që zhvillojnë aktivitete në bashkitë pjesë e programit do të zbatohen projekte që adresojnë prioritetet e përcaktuara në strategjitë e tyre të zhvillimit. Financimi i projekteve të para pritet gjatë vitit 2018, kur rezultatet e para dhe impakti do të maten jo vetëm në aspektin e kontributit në fuqizimin dhe qëndrueshmërinë e OSHC-ve lokale, por edhe në efektivitetin e procedurës së përdorur në shpërndarjen e fondeve publike për OSHC-të në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Organizatat e Shoqërisë Civile të financuara nga qeveria janë subjekt i Ligjit Nr. 112/2015 për Inspektimin Financiar Publik<sup>25</sup> që synon të garantojë përdorimin e fondeve publike në përputhje me legjislacionin. Disa nga përmirësimet më të rëndësishme të bëra në lidhje me procedurat në dy vitet e fundit janë renditur si më poshtë:

1. Organizata jofitimprurëse, subjekt i auditimit nuk është më e detyruar të ndërpresë të gjitha aktivitetet e saj gjatë inspektimit.
2. Afati ligjor i datës së fillimit dhe përfundimit të një inspektimi është parashikuar në procedurat e reja.
3. Subjekti i auditimit ka të drejtë të lexojë raportin përfundimtar, të dëgjohet dhe të apelojë vendimin pas përfundimit të inspektimit.
4. Sa i përket transparencës, të gjitha raportet tani publikohen në faqen zyrtare të ministrisë dhe janë lehtësisht të aksesueshme.

<sup>25</sup> Ligji fillimisht u miratua në vitin 2010 pas dekretimit në Parlamentin Shqiptar pa ndonjë konsultim me shoqërinë civile. Pas shumë kundërshtimeve dhe rekomandimeve të shumta nga BE-ja (në lidhje me përafrimin e legjislacionit si një vend me statusin kandidatit për tu bërë pjesë e Bashkimit Evropian), ai u ndryshua vetëm në vitin 2015 duke përfshirë miratimin dhe hyrjen në fuqi të udhëzimeve dhe urdhrave përkatës që mbështesin ligjin:  
- Udhëzimi nr. 30, datë 27.11.2015 "Për rregullat dhe procedurat për kryerjen e inspektimit financiar publik"  
- Udhëzimi nr. 29, datë 27.11.2015 "Për kriteret për fillimin e inspektimit financiar publik"  
- Urdhri nr. 85, datë 09.12.2015 "Për miratimin e Kodit të Etikës për Inspektorët Financiarë Publikë"  
- Urdhri nr.26, datë 17.02.2016 "Për miratimin e Manualit të Inspektimeve Financiare Publike"

Një inspektim financiar publik mund të iniciohet vetëm nëse një kërkesë, informacion ose ankesë është paraqitur zyrtarisht në protokollin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në përputhje me kërkesat ligjore<sup>26</sup>. Sipas informacionit të publikuar në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë, në dy vitet e fundit janë kryer rreth 28 inspektime në total dhe vetëm një

OSHC ka qenë subjekt i inspektimit financiar. Në raportet përmbledhëse të publikuara për secilin inspektim nuk tregohet periudha në të cilën është kryer inspektimi dhe as burimi i financimit të inspektuar (p.sh. fondet nga donatorë, kontrata tenderi etj).

Megjithëse kuadri ligjor i inspektimit financiar publik është përmirësuar ndjeshëm (kjo edhe pas kërkesave të Komisionit Evropian për përmirësimin e legjislacionit), në raportet e progresit të këtij të fundit përmendet mungesa e kapaciteteve njerëzore dhe spektri i kufizuar i problematikave të trajtuara për vitin 2017.

<sup>26</sup> Burimet e të cilave mund të jenë: Kërkesat nga Drejtuesit e Institucioneve Qendrore dhe Lokale, Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurorit të Përgjithshëm dhe OLAF (Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit); Informacion mbi parregullsitë nga auditimi i brendshëm ose menaxhimi financiar dhe kontrolli dhe Ankesat nga punonjësit në sektorin publik ose privat, nga çdo individ / person juridik përfshi dhe nga ata anonimë.

Vlerësimi i Standardit 2, të Nën-fushës 2.4., reflekton gjithashtu vlerësimin e indikatorëve të mëposhtëm të **Udhëzimeve të Bashkimit Evropian për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në Vendet e Zgjerimit, 2014-2020**. Gjetjet bazuar në objektivat për secilin indikator janë:

#### **2.4.a. Perceptimi i OSHC-ve në sigurimin e fondeve në aspektet e transparencës, të drejtës dhe jo-diskriminimit**

Vlerësimi i OSHC-ve për kriteret e njoftimit, përzgjedhjes dhe shpërndarjes së fondeve publike mbetet në një masë të madhe negative. Kjo përsërit një gjetje konstante të viteve të fundit sipas së cilës kriteret e përzgjedhjes nuk janë transparente dhe të bazuara në merita, dhe procesi i vendimarrjes vuan nga konflikti i interesit ende i pranishëm dhe i pa-adresuar siç duhet.

#### **2.4.c. Cilësia e kuadrit të financimit shtetëror për organizatat e shoqërisë civile (që fokusohet në dokumentin procedural)**

Situata me financimin publik sa i përket buxhetit vjetor të përcaktuar, si dhe rregullave e procedurave për menaxhimin e tij, mbetet e njëjtë. Financimi publik mbetet në nivele të kufizuara, duke arritur të mbështesë vetëm një numër të vogël të OSHC-ve. Ai nuk ka mundur të adresojë nevojat prioritare kyçe të sektorit sepse nuk mbështetet në strategji të mirë-planifikuara dhe afatgjatë.

### **Nën-fusha 2.3 Burimet njerëzore**

Nuk ka të dhëna zyrtare mbi numrin e përgjithshëm të punonjësve që punojnë në sektorin e OSHC-ve. Bazuar në informacionin zyrtar të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të marrë me kërkesë zyrtare të Partnerëve Shqipëri, numri mesatar i të punësuarve në sektorin jofitimprurës për vitin 2017 është 9,400 (përfshirë punonjësit e përhershëm dhe ata me orar të pjesshëm), rreth 1,200 më shumë krahasuar me një vit më parë.

Një nga shqetësimet kryesore lidhur me këtë është detyrimi i OSHC-ve për të pasur një punonjës të përhershëm, pavarësisht natyrës së saj (p.sh. organizatë vullnetare) apo aktivitetit (p.sh. OSHC që e ushtron aktivitetin bazuar në fondet në dispozicion).

Sektori i OSHC-ve mbetet i varur nga donatorët me angazhim dhe veprimtari të fragmentuar në pjesën më të madhe të tij dhe si rezultat i pamundur të ketë punonjës të përhershëm të paguar. Ky detyrim, i cili i sjell sektorit edhe gjoba të rënda, është demonstrim i mungesës së të



kuptuarit nga ana e shtetit të rolit dhe natyrës së punës së OSHC-ve, duke i njësuar ato me sektorin privat.

Vullnetarët janë një pjesë e rëndësishme e burimeve njerëzore të OSHC-ve. Pas shumë vitesh diskutimi, Ligji për Vullnetarizmin u miratua në prill të vitit 2016<sup>27</sup>. Aktet nënligjore pjesë e paketës ligjore nuk janë hartuar ende. Ato pritet të adresojnë çështje të rëndësishme si krijimi i regjistrit të vullnetarëve, mbështetje për qendrat vullnetare, krijimin e skemave shtetërore të

<sup>27</sup> Ligji nr 45/2016 "Për Vullnetarizmin"

financimit, krijimin e instrumenteve për mbledhjen e të dhënave mbi aktivitetin vullnetar në vend dhe kodin etik mbi vullnetarizmin. Si rezultat, OSHC-të janë duke u përballur ende me vështirësitë dhe pasiguritë e të përfshirit të vullnetarëve në projektet dhe aktivitetet e tyre, duke u ekspozuar ndaj rrezikut të gjobave.

Duke marrë parasysh situatën, dy rekomandimet kryesore në këtë fushë mbeten: së pari, heqja e detyrimit për pasjen e një punonjësi të përhershëm të paguar, dhe plotësimin e kuadrit ligjor në mbështetje të vullnetarizmit.

Vlerësimi i Standardit 2, të Nën-fushës 2.3., reflekton gjithashtu vlerësimet e indikatorëve të mëposhtëm të **Udhëzimeve të Bashkimit Evropian për Mbështetjen e Shoqërinë Civile në Vendet e Zgjerimit, 2014-2020**. Gjetjet bazuar në objektivat për secilin indikator janë:

#### **1.2.a. Numri i punonjësve në OSHC (të përhershëm dhe me kohë të pjesshme)**

Nuk ka të dhëna zyrtare të publikuara për numrin total të të punësuarve në sektorin jofitimprurës. Numri mesatar për 2017 është 9,400, duke përfshirë punonjësit e përhershëm dhe ata me kohë të pjesshme<sup>28</sup>.

#### **1.2. d. Numri i vullnetarëve në OSHC sipas llojit të OSHC-së/sektorit**

Nuk ka të dhëna zyrtare për numrin e vullnetarëve që angazhohen në OSHC. Në takimet konsultuese me sektorin, disa OSHC raportojnë se janë dënuar me gjoba nga inspektorët tatimorë për angazhimin e punonjësve të paregjistruar gjatë kontrolleve të fushatave kundër informalitetit vitin e kaluar.

#### **1.2. f. Cilësia e kuadrit ligjor**

Kuadri ligjor që rregullon punësimin dhe vullnetarizmin nuk është mundësues për OSHC-të. Duhet të rishikohen aktet që i detyrojnë organizatat të regjistrojnë, deklarojnë dhe paguajnë kontributet mujore të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për të paktën një punonjës dhe duhet të plotësohet kuadri ligjor për vullnetarizmin me të gjitha aktet nënligjore të parashikuara në Ligjin për Vullnetarizmin.

<sup>28</sup> Me kërkesë zyrtare për informacion nga Partnerët Shqipëri për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve

## Fusha 3: Marrëdhënia Shtet – OSHC

### Nën-Fusha 3.1 Kuadri Ligjor dhe praktik për bashkëpunim

Një shoqëri civile e fuqizuar është një faktor thelbësor për një sistem demokratik në hartimin dhe zbatimin e politikave publike. Dialogu dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm midis shtetit dhe OSHC-ve duhet të rrënohet në funksionimin e institucioneve shtetërore, të njihen përmes politikave dhe strategjive shtetërore dhe të shoqërohen me plane veprimi.

Në vitin 2015, u miratua **Udhërrëfytyesi për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Shoqërinë Civile** (Fletorja Zyrtare 94/2015), dokumenti kryesor strategjik i qeverisë që njeh rëndësinë e zhvillimit dhe bashkëpunimin me këtë sektor. Duke qenë në përputhje me **Udhëzimet e Bashkimit Evropian për Mbështetjen e Shoqërinë Civile në Vendet e Zgjerimit, 2014-2020** të zhvilluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Zgjerimit të Komisionit Evropian me qëllim të zhvillimit të një mjedisi mundësues dhe stimulues për shoqërinë civile, ajo përcakton politikën e qeverisë drejt një mjedisi më të favorshëm për shoqërinë civile të bazuar në nëntë fusha prioritare, të cilat janë përcaktuar përmes një procesi konsultativ me shoqërinë civile, duke përfshirë edhe veprimet konkrete që duhet të zbatohen në mbështetje të arritjes së secilës fushë prioritare.

Udhërrëfytyesi përmban 55 veprime të propozuara dhe rreth 80% e këtyre veprimeve nuk janë zbatuar deri në fund të vitit 2017. Veprimet që kanë pasur progres në zbatimin e tyre janë ato që janë iniciuar ose mbështetur fuqishëm nga shoqëria civile, si themelimi i Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile, rritja e transparencës së Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, miratimi i Ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, miratimi i Ligjit për Vullnetarizmin dhe miratimi i Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit për OSHC-të. Deri në fund të vitit 2017, me mbështetjen teknike të ofruar nga Delegacioni i BE në Shqipëri, Zyra e Kryeministrit filloi për herë të parë miratimin e një procesi monitorimi dhe rishikimi të Udhërrëfytyesit, së bashku me ndihmën teknike për përmirësimin e dokumentit, i cili pritet të finalizohet deri në vitin 2018.

**Këshilli Kombëtar i Shoqërisë Civile**, një

mekanizëm për bashkëpunimin midis shtetit dhe OSHC-ve u krijua në vitin 2015 si një organ konsultativ kolegial që synon të garantojë bashkëpunimin institucional me OSHC-të, në mbështetje të qeverisjes së mirë, demokracisë me pjesëmarrje dhe rritjes së transparencës përmes pjesëmarrjes dhe përfshirjes së shoqërisë civile në këtë proces. Përbërja e Këshillit është përcaktuar me ligj, në bazë të së cilit 13 përfaqësues duhet të jenë nga institucionet qeveritare, 13 përfaqësues nga OSHC-të dhe 1 përfaqësues nga Këshilli Ekonomik Kombëtar<sup>29</sup>. Ligji përcakton gjithashtu ministrinë që duhet të kenë përfaqësuesin e tyre (në nivel zëvendësministrash ose në nivele të larta drejtuesish) në Këshill dhe procedurën e përzgjedhjes së përfaqësuesve të shoqërisë civile.

Këshilli filloi punën në mbledhjen e tij të parë më 23 qershor 2016, organizuar në ambientet e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ku u prezantuan anëtarët e Këshillit dhe u zgjodh grupi i punës për përgatitjen e rregullores së brendshme të tij<sup>30</sup>. Ky ishte takimi i vetëm i Këshillit për vitin 2016. Takimi i dytë u organizua më 15 shkurt 2017<sup>31</sup>, dhe një takim i tretë më 26 dhjetor 2017<sup>32</sup>. Mbledhjet e Këshillit kanë qenë të hapura për publikun dhe OSHC-të janë ftuar për të marrë pjesë në takim. Edhe pse ligji parashikon që Këshilli duhet të mbledhet të paktën tre (3) herë në vit, kjo kërkesë e ligjit nuk u respektua në vitin 2017.

Pavarësisht dy takimeve, Këshilli nuk ndërmori ndonjë diskutim apo vendim produktiv. Puna e tij dhe procesi vendim-marrës u ndikua shumë nga struktura e qeverisë së re të formuar pas zgjedhjeve parlamentare të 25 korrikut. Qeveria e re e krijuar nga partia Socialiste paraqiti një ristrukturim të portofolit ministror duke i reduktuar ato nga 17 në 13. Ndryshimet sollën shkrirjen (bashkimin) e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë me Ministrinë e Shëndetësisë, kur ndërkohë ministri i së parës ishte edhe kryetar i Këshillit, shkrirjen e Ministrisë së Integritimit Evropian me Ministrinë e Punëve

<sup>29</sup> Ligji nr. 119/2015 "Për Krijimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile"

<sup>30</sup> [https://www.facebook.com/pg/Agjencia-per-Mbeshtetjen-e-Shoqerise-Civile-AMSHC-506935452766029/photos/?tab=album&album\\_id=960960550696848](https://www.facebook.com/pg/Agjencia-per-Mbeshtetjen-e-Shoqerise-Civile-AMSHC-506935452766029/photos/?tab=album&album_id=960960550696848)

<sup>31</sup> [https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=111370652322503&id=506935452766029&substory\\_index=0](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=111370652322503&id=506935452766029&substory_index=0)

<sup>32</sup> [https://www.facebook.com/pg/Agjencia-per-Mbeshtetjen-e-Shoqerise-Civile-AMSHC-506935452766029/photos/?tab=album&album\\_id=1404970239629208](https://www.facebook.com/pg/Agjencia-per-Mbeshtetjen-e-Shoqerise-Civile-AMSHC-506935452766029/photos/?tab=album&album_id=1404970239629208)

të Jashtme, si dhe u shpërbënë dy portofola ministrorë, Ministria e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike si dhe Ministria e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin. Këto ndryshime sollën nevojën për ndryshime ligjore në ligjin për krijimin dhe funksionimin e Këshillit. Deri më sot këto ndryshime nuk janë bërë. Boshllëku i krijuar u vendos të adresohet nëpërmjet vendimit të Këshillit të datës 26 dhjetor 2017, i cili iu dha të drejtën ministrive të reja që meqenëse kishin zgjeruar fushën e veprimit dhe funksionet, të kishin më shumë se një përfaqësues. Pavarësisht kësaj, është e rëndësishme të vihet në dukje se një vendim i tillë është në kundërshtim me ligjin dhe autoritetin e Këshillit për të tejkaluar ligjin.

Përveç kësaj, legjitimiteti i kryetarit të Këshillit është vënë në pikëpyetje, sepse sipas ligjit ky funksion duhet të kryhet nga Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ndërkohë që momentalisht kryetar është Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Një tjetër problematikë e hasur gjatë vitit 2017 lidhur me funksionimin e Këshillit ka të bëjë me mandatin e anëtarëve të tij nga shoqëria civile. Neni 16 i ligjit për Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile përcakton se katër (4) anëtarë të Këshillit nga shoqëria civile do të kenë një mandat njëvjeçar, katër (4) anëtarë të tjerë do të kenë një mandat dyvjeçar dhe pesë (5) anëtarë do të kenë një mandat trevjeçar. Më 1 mars, anëtarët e Këshillit nga shoqëria civile organizuan llotarinë për të vendosur mbi kohëzgjatjen e mandateve të tyre, ndërsa zyrtarisht kohëzgjatja e mandatit të tyre filloi vetëm më 26 dhjetor (nëntë muaj më vonë), me vendim të Këshillit që lidh kohëzgjatjen e

mandatit me miratimin e rregullores së Këshillit<sup>33</sup>.

Në vitin 2017 u vu re edhe mungesa e ndërveprimit të anëtarëve të shoqërisë civile në Këshill me OSHC të tjera që ato përfaqësojnë. Anëtarët nga shoqëria civile zgjidhen sipas tre sektorëve: (1) demokracia, shteti i së drejtës, të drejtat e njeriut dhe integrimi në BE; (2) zhvillimi ekonomik, territorial dhe mjedisor; (3) mirëqenia, shërbimet sociale, mbrojtja e shëndetit dhe përmirësimi i cilësisë së jetës. Nuk ka pasur diskutime të organizuara nga anëtarët e Këshillit me organizata të tjera që punojnë në këto fusha për çështjet që duhet të përfshihen në axhendën e punës së tij. Vetëm si pjesë e asistencës teknike të BE-së, Këshilli u përfshi në konsultime me OSHC-të për Udhërrëfyesin, të organizuara nga asistencë teknike.

Duke marrë parasysh situatën, nevojiten disa veprime të menjëhershme duke përfshirë këtu edhe ndryshimin e Ligjit për Krijimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile për të adresuar çështjen e përfaqësimit të qeverisë në Këshill si dhe të japi më shumë qartësi mbi mandatet e anëtarëve nga shoqëria civile. Përveç kësaj, nga anëtarët e Këshillit që vijnë nga shoqëria civile pritet një komunikim dhe ndërveprim më i madh me OSHC-të që ata përfaqësojnë sipas fushave. Kjo do të kontribuojë, në mënyrë direkte në më shumë koordinim dhe përpjekje strategjike nga sektori në punën me institucionet shtetërore për krijimin e një mjedisi mundësues për funksionimin e OSHC-ve dhe përmirësimin e jetës së përfituesve të tyre.

<sup>33</sup> [https://drive.google.com/file/d/1tO\\_vL2TgE2MkrM-mTOz6hVd9Sq2fyGd94/view](https://drive.google.com/file/d/1tO_vL2TgE2MkrM-mTOz6hVd9Sq2fyGd94/view)

Vlerësimi i Standardit 3, i Nën Fushës 3.1 reflekton gjithashtu vlerësimet e indikatorëve të mëposhtëm të **Udhëzimeve të Bashkimit Evropian për Mbështetjen e Shoqërinë Civile në Vendet e Zgjerimit, 2014-2020**. Gjetjet janë bazuar në targetin për secilin indikator.

**3.1.b. Cilësia e strukturave dhe mekanizmave ekzistuese për dialog dhe bashkëpunim midis OSHC-ve dhe institucioneve publike në aspektin e:** - përfaqësimit të OSHC-së në përgjithësi, - përfaqësimit të OSHC-ve më të vogla/më të dobëta; - vizibilitetit dhe dispozicionit, - perceptimit të qeverisë mbi cilësinë e strukturave dhe mekanizmave, - perceptimit të OSHC-ve mbi strukturat dhe mekanizmat.

- Deri në fund të vitit 2017, shumica e veprimeve të propozuara në Udhërrëfyesin për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Shoqërinë Civile ende nuk janë zbatuar, ndërsa Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile nuk ka funksionuar dhe nuk ka pasur rezultate konkrete të punës së tij që nga krijimi i tij.

### Nën-fusha 3.2 Përfshirja në proceset e politikëbërjes dhe vendimmarrjes

Kuadri ligjor që ndikon në përfshirjen e OSHC-ve në politikë dhe vendimmarrje nuk ka ndryshuar në vitin 2017. Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe ligji nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik" janë ligjet kryesore që garantojnë të drejtën e OSHC-ve dhe qytetarëve përfshirjen dhe ndikimin në proceset e politikëbërjes dhe vendimmarrjes. Një diskutim me palët e interesuara u iniciua në vitin 2017 nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale, ku u përfshinë edhe OSHC-të, për ndryshimin e Ligjit Nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", me qëllim forcimin e rolit të Komisionerit, por asnjë iniciativë ligjore nuk është ndërmarrë deri më tani. Përmirësimi i ligjit mbetet një nga prioritetet e Komisionerit për vitin 2018.

Bazuar në gjetjet e disa raporteve mbi ndikimin e këtyre ligjeve, përfshirë këtu edhe Raportet e Matricës së Monitorimit për vitet e mëparshme, vlerësohet se ato kanë kontribuar në rritjen e komunikimit dhe transparencës së institucioneve publike ndaj qytetarëve. Gjithashtu, është vënë re ndërgjegjësimi i institucioneve publike për detyrimet e tyre ligjore për të siguruar informacion dhe për të përfshirë qytetarët në procesin e tyre të politikëbërjes dhe vendimmarrjes. Një tregues i këtij fakti është se vetëm 4.7% e kërkesave për informacion të marrë nga 108 autoritetet publike janë refuzuar<sup>34</sup>. Problemi kryesor me zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit mbetet sasia dhe cilësia e informacionit të ofruar nga institucioni publik. Në shumë raste, sidomos në rastet kur informacioni i kërkuar është sensitiv, përgjigja e dhënë është e pjesshme, shumë e përgjithshme ose nuk jepet fare. Në disa raste, institucionet publike nuk kanë kapacitete dhe burime për të mbledhur dhe për të prodhuar informacionin e kërkuar.

Duke iu referuar të dhënave nga Raporti Vjetor 2017 i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale si dhe nga monitorimi i të gjitha Autoriteteve Publike rezultoi se 181 prej tyre kanë miratuar dhe bërë publike Programin e Transparencës; 227 kanë caktuar koordinatorin për të drejtën e informimit, ndërsa

<sup>34</sup> [http://www.idp.al/wp-content/uploads/2018/02/RAPORTI\\_VJETOR\\_2017.pdf](http://www.idp.al/wp-content/uploads/2018/02/RAPORTI_VJETOR_2017.pdf)

124 kanë publikuar regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve. Janë paraqitur 560 ankesa në Zyrën e Komisionerit, nga të cilët 130 nga organizatat e shoqërisë civile dhe 430 nga individë<sup>35</sup>.

Situata më problematike sa i përket transparencës haset në institucionet e qeverisë qendrore. Ndonëse pati përmirësime të dukshme në gjashtë muajt e parë të vitit 2017, kur të gjitha ministritë kishin emëruar koordinatorët e tyre për të drejtën e informimit dhe programet e transparencës, kjo situatë ndryshoi pas qershorit 2017 për shkak të zgjedhjeve parlamentare dhe ristrukturimit të qeverisë. Si rrjedhim, zbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga ligji "Për të drejtën e informimit" u përkeqësua ndjeshëm<sup>36</sup>.

Sa i përket qeverisjes vendore, Zyra e Komisionerit ka konstatuar përmirësim të nivelit të transparencës nga ana e bashkive. Të gjitha bashkitë kanë emëruar koordinatorët për të drejtën e informimit, kanë trajtuar rreth 9,308 kërkesa për informacion publik dhe kanë refuzuar rreth 245 kërkesa në total gjatë vitit 2017. Studimet e fundit tregojnë se niveli mesatar i transparencës në lidhje me dhënien e informacionit nga njësitë e qeverisjes vendore është 57% dhe rreth gjysma e 61 bashkive kanë miratuar Programin e Transparencës<sup>37</sup>. Shumica e bashkive (44) kanë një faqe zyrtare, por ato përditësojnë informacione minimale. Shumica e bashkive nuk kanë një program transparence dhe as regjistër të publikuar kërkesash dhe përgjigjesh<sup>38</sup>. Përveç kësaj, nga monitorimi i portalit <http://www.konsultimipublik.gov.al>, rezultatet tregojnë se nuk ka njoftime të publikuara nga bashkitë për konsultimet publike, edhe pse ato detyrohen sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 828, datë 07.10.2015 "Për miratimin e rregullave për krijimin dhe administrimin e regjistrit elektronik për njoftim dhe konsultim publik".

Sa i përket OSHC-ve, mënyrat e bashkëpunimit me pushtetin lokal për të trajtuar çështjet specifike apo për të kontribuar në vendimmarrje janë ende të kufizuara. Ka shumë pak forume të hapura në bashkitë ku OSHC-të të mund të angazhohen dhe japin zë shqetësimeve të qytetarëve, ndërsa

<sup>35</sup> Idem

<sup>36</sup> Idem

<sup>37</sup> BIRN (2017), Pushteti Vendor nën Lentën e të Drejtës për Informim: Një vlerësim krahasues i treguesve të transparencës në terren dhe online, Tiranë

<sup>38</sup> [http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/LG\\_Mapping\\_al.pdf](http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/LG_Mapping_al.pdf)

në bashkitë e vogla aktiviteti i OSHC-ve është i kufizuar ose shumë i dobët. Sektori i OSHC-ve ende vuan nga kapacitete të dobëta për të lobuar, advokuar dhe ndikuar në vendimmarrjen vendore me efektivitet<sup>39</sup>.

Në vitin e fundit, ka pasur iniciativa që kanë kontribuar në rritjen e aktivizimit të shoqërisë civile, si LëvizAlbania, një projekt i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim e zbatuar nëpërmjet konsorciumit të organizatave Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe Co-Plan. Që nga 2016, nëpërmjet skemave të nën-grantimit, LëvizAlbania ka mbështetur 127 iniciativa lokale të organizatave komunitare, medias, institucioneve akademike, grupeve të rinjve dhe grave si dhe individëve, të fokusuara në advokasi, monitorimin e performancës së qeverisjes vendore, pjesëmarrjen qytetare në vendim-marrjen lokale, transparencën dhe llogaridhëniem e bashkive etj. Nëpërmjet angazhimit të aktorëve të shoqërisë civile dhe individëve si kampionë të demokracisë, LëvizAlbania ka kontribuar në forcimin e demokracisë vendore në Shqipëri.

Janë krijuar dy platforma online me qëllim ofrimin e informacionit dhe asistencës për qytetarët për të drejtën e tyre për informim dhe konsultim publik: [www.pyetshtetin.al](http://www.pyetshtetin.al), krijuar si një iniciativë e përbashkët e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale dhe Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, dhe [www.publeaks.al](http://www.publeaks.al), krijuar nga Res Publica, e cila ofron gjithashtu mundësinë për të gjurmuar përgjigjet e dhëna on-line.

Një tregues tjetër i përfshirjes efektive të OSHC-ve në proceset e politikëbërjes dhe vendimmarrjes është pjesëmarrja e tyre në organet ndërsektoriale për të cilat nuk ekziston një kuadër ligjor specifik që rregullon përfshirjen e OSHC-ve dhe kriteret e përzgjedhjes. Pavarësisht kësaj, OSHC-të janë pjesë e disa organeve ndërsektoriale, kryesisht konsultative dhe këshilluese, si Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian (i cili deri në vitin 2018 pritet të zgjerohet pjesëmarrjen e anëtarëve nga

shoqëria civile), Këshilli Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara, Këshilli për Barazi Gjinore etj. Mungesa e kërkesave dhe procedurave të qarta për përfshirjen e OSHC-ve në organet ndërsektoriale ka ndikuar në pjesëmarrje të ulët të OSHC-ve, transparencë të ulët në procesin e përzgjedhjes dhe përfaqësim të ulët të OSHC-ve nga anëtarët e përzgjedhur në këto struktura.

Në vitin 2017, në kuadër të Reformës në Drejtësi, shoqëria civile u përfshi në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Bazuar në Ligjin nr.115/2016, datë 3.11.2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", parlamenti ka të drejtë të zgjedhë një anëtar nga shoqëria civile për secilin nga këto organe. Zgjedhja bëhet përmes një procesi të hapur ku secili anëtar i organizatave të shoqërisë civile që plotëson kriteret e përcaktuara në ligj ka të drejtë të aplikojë. Një komision ad hoc i përbërë nga 5 anëtarë nga shoqëria civile (i zgjedhur gjithashtu përmes një procesi të hapur aplikimi nga Avokati i Popullit) u krijua për të bërë verifikimin paraprak të kandidatëve nga shoqëria civile për të dy organet dhe për t'i përcjellë Sekretarit të Përgjithshëm të Parlamentit listën e kandidatëve me rezultatet më të larta, në përputhje me dispozitat e ligjit.

Në përgjithësi, mund të thuhet se ende ka shumë punë për të bërë për të plotësuar treguesit që do të siguronin një përfshirje efektive të OSHC-ve në procesin e politikëbërjes dhe vendimmarrjes. Përmirësimi i ligjit për informim dhe konsultim publik është i nevojshëm për zbatimin e tyre dhe për të rritur përgjegjshmërinë e institucioneve publike, së bashku me zbatimin e veprimeve të propozuara në Udhërrëfyes për të rritur efektivitetin e organizimit dhe raportimit mbi konsultimet publike si dhe kapacitetet e nëpunësve civilë dhe stafit të bashkive. Gjithashtu, emërimi i personave të kontaktit për bashkëpunim me OSHC-të në ministri, bashki apo institucione të tjera publike dhe organizimi i takimeve periodike koordinuese (veprimet e propozuara 2.9, 2.10 dhe 2.11 të Udhërrëfyesit) do të jepte kontribut në këtë proces. Nga ana tjetër, OSHC-të duhet të trajnohen dhe të fuqizohen që të marrin pjesë dhe të kontribuojnë në mënyrë efektive.

<sup>39</sup> Idem



Vlerësimi i Standartit 3, Nën fusha 3.2., reflekton gjithashtu vlerësimin e indikatorëve të mëposhtëm të **Udhëzimeve të Bashkimit Evropian për Mbështetjen e Shoqërinë Civile në Vendet e Zgjerimit, 2014-2020**. Gjetjet bazuar në objektivat për secilin indikator janë:

**3.1.a. Përqindja e ligjeve/ akteve nënligjore, strategjive dhe reformave të politikës të konsultuara me OSHC-të në aspektin e:** - aksesit të duhur ndaj informacionit; - kohës së mjaftueshme për të komentuar; - përzgjedhjes dhe përfaqësisë/ diversitetit të grupeve të punës; - njohjes së kontributit; - shkallës në të cilën informacioni merret në konsideratë; - reagimit/ publikimit të rezultateve të konsultimit.

-Nuk ka informacion të disponueshëm për të matur këtë tregues. Zbatimi i veprimit të propozuar 3.4 të Udhërrëfyesit për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Shoqërinë Civile, do të bënte të mundur grumbullimin dhe analizimin e të dhënave për të vlerësuar treguesin.

### **Nën-fusha 3.3 Bashkëpunimi në ofrimin e shërbimeve**

Ndryshimet në Ligjin për Prokurimin Publik në vitin 2017<sup>40</sup> nuk sollën ndonjë ndryshim në lidhje me pjesëmarrjen e OSHC-ve në procedurat e prokurimit publik. Rregullat e tenderimit janë të unifikuara dhe zbatohen në mënyrë të barabartë si për OSHC-të ashtu dhe për subjektet e tjera private ofertuese. Kriteri kryesor për fitimin në prokurimin publik është çmimi më i ulët i ofruar duke shpërfillur cilësinë e shërbimit. Përveç kësaj, shpenzimet e lidhura me tenderimin dhe kushtet financiare të kontratave (d.m.th. fondi i garancisë, rimbursimi i shpenzimeve kundrejt parapagimit, skedulë jo e qartë dhe e rregullt e pagesave) paraqesin një pengesë serioze për pjesëmarrjen e OSHC-ve në çfarëdo procedure tenderimi.

Situata nuk është përmirësuar edhe pas miratimit të Ligjit për Ndërmarrjet Sociale në vitin 2016, i cili rregullon organizimin dhe funksionimin e ndërmarrjeve sociale. Ligji është shumë problematik dhe ka pasur disa iniciativa nga OSHC-të gjatë fazës së hartimit për të influencuar në projektimin e tij, por rekomandimet e dhëna nuk u morën në konsideratë. Ligji është hartuar duke marrë në konsideratë vetëm modelin e integritimit

në punë, i cili kërkon që të paktën 3 punonjës me kohë të plotë ose 30% e punonjësve t'i përkasin grupeve të marginalizuara (siç kërkohet me ligj). Ligji është i paqartë në lidhje me stimujt financiarë dhe ky aspekt pritet të rregullohet nga një akt nënligjor i cili nuk ka hyrë ende në fuqi.

Edhe pse prokurimi publik konsiderohet nga ligji si një nga instrumentet për të mbështetur aktivitetin e ndërmarrjeve sociale, nuk ka një kuptim të qartë nga institucionet se si kjo gjë do të funksionojë, duke marrë në konsideratë të gjitha çështjet e listuara më lart.

Deri në vitin 2017 nuk u miratua asnjë nga aktet nënligjore të parashikuara, dhe si rezultat asnjë OSHC nuk u regjistrua si ndërmarrje sociale.

Për ta përmbledhur, edhe pse OSHC-të janë aktorët kryesorë që ofrojnë shërbime cilësore sociale për një gamë të gjerë përfituesish, ende kuadri ligjor dhe rregullator paraqet shumë sfida dhe problematika për t'u adresuar në mënyrë që të krijohet një mjedis mundësues për përfshirjen e OSHC-ve në ofrimin e shërbimeve sociale me fonde publike. Rishikimi i kuadrit ligjor dhe përgatitja e një procedure të re të prokurimit social, për të siguruar një kontraktim efektiv të OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve, ku cilësia e shërbimit do të ishte kriter kryesor në përzgjedhje dhe jo çmimi, mbetet rekomandimi kryesor në këtë fushë.

<sup>40</sup> Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar me Ligjin nr. 9800, datë 10.09.2007, Ligjin Nr. 9855, datë 26.12.2007, Ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009, Ligjin Nr. 10 309, datë 22.07.2010, Ligjin nr. 22/2012, Ligjin nr. 131/2012, Ligjin nr. 182/2014 dhe Ligjin nr. 47/2017

## V. Burime të përdorura dhe lidhje të dobishme



### Lista e dokumenteve ligjorë dhe strategjikë, raporteve dhe analizave të përdorura:

1. Informacion i marrë në bazë të kërkesave zyrtare të dërguara institucioneve nga Partnerët Shqipëri
2. Monitorimi i së Drejtës për Tubime Paqësore - Raporti për Shqipërinë 2016-2017. Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, ECNL
3. Trajtimi fiskal i OJF-ve / Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim
4. Fakte mbi Aktivitetin Filantropik 2017, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim
5. USAID 2017, Indeksi i Qëndrueshmërisë së OSHC-ve 2016 për Evropën Qendrore, Lindore dhe Euroazinë
6. Liria në Botë 2018 Link
7. Ligji nr. 92/2014, "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë"
8. Udhëzimi nr. 6 datë 30.01.2015 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë".
9. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 953, datë 29.12.2014 "Për zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 92/2014"
10. Ligji Nr. 9840, datë 10.12.2007 "Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Evropiane, për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA)"
11. Ligji nr. 10192, i vitit 2009 dhe i ndryshuar më 2017, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë"
12. Ligji Nr. 112/2015 "Për Inspektimin Financiar Publik"
13. Ligji nr.119 / 2015 "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile"
14. Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar me Ligjin nr. 9800, datë 10.09.2007, Ligjin Nr. 9855, datë 26.12.2007, Ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009, Ligjin Nr. 10 309, datë 22.07.2010, Ligjin nr. 22/2012, Ligjin nr. 131/2012, Ligjin nr. 182/2014 dhe Ligjin nr. 47/2017

15. Ligji nr. 8773, datë 23.4.2001 “Mbi Tubimet”
16. Ligji nr.119 / 2014 “Për të drejtën e informimit”
17. Udhëzimi nr. 24 datë 02.09.2008 “Për Procedurat tatimore, të ndryshuar”
18. Udhëzim mbi ligjin nr. 5 datë 30.01.2006
19. Rregullore për NCCS- aprovuar më 26.12.2017
20. Udhëzimi nr. 22. Për mbikëqyrjen e OJF-ve

**Lidhje të dobishme në internet:**

1. [www.thealbaniancrowd.org](http://www.thealbaniancrowd.org)
2. [www.freedomhouse.org](http://www.freedomhouse.org)
3. [www.kultura.gov.al](http://www.kultura.gov.al)
4. [www.al.undp.org](http://www.al.undp.org)
5. [www.idp.al](http://www.idp.al)
6. [www.lotaria.al](http://www.lotaria.al)
7. [www.media.ba](http://www.media.ba)
8. [www.amshc.gov.al](http://www.amshc.gov.al)
9. [www.pyetshtetin.al](http://www.pyetshtetin.al)
10. [www.publeaks.al](http://www.publeaks.al)
11. [www.konsultimipublik.gov.al](http://www.konsultimipublik.gov.al)





**RAPORTI PËR SHQIPËRINË**

2017